

1 E premte, 14 korrik 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.10

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,  
12 të gjithëve. Ju kërkoj ndjesë për vonesën. Përgjegjësia është  
13 e imja tërësisht.

14 Sot do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04746.  
15 Vërej që z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi janë  
16 të gjithë të pranishëm në sallën e gjyqit sot.

17 Përpara sesa të ftoj dëshmitarin në sallën e gjyqit, ka  
18 disa çështje administrative të cilat duhet t'i trajtojmë.

19 Së pari, Trupi Gjykues dëshiroj që t'i japë fjalën  
20 Mbrojtjes për të na thënë se cili është vlerësimi i tyre për  
21 kohën që i nevojitet për të marrë në pyetje Dëshmitarin 04746.

22 Mbrojtja e z. Thaçi, ka ndonjë ndryshim, z. Misetic?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka ndryshim.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Sikurse e thashë edhe më herët do  
25 e rishikojmë kohën tonë për të marrë në pyetje dëshmitarin,

1 megjithatë mendoj që për momentin do të duhen rreth dy orë.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

3 Ne mendojmë që do të na duhen pesë orë.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne  
5 parashikojmë që të na duhen katër orë për të marrë në pyetje  
6 dëshmitarin.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykues  
8 është i mendimit që kundërpjetjet mund të jenë disi të  
9 ekzagjeruara ose të zgjatura, pra, janë planifikuar më shumë  
10 se ç' duhet megjithatë nuk është se do futemi në ndonjë  
11 argument për juve lidhur me këtë. E vlerësojmë shkurtimin e  
12 kohës aq sa e keni shkurtuar. Sa i takon asaj çfarë dëgjuam  
13 nga ekipet e Mbrojtjes dhe duke marrë parasysh edhe pyetjet  
14 plotësuese që mund të bëhen nga ZPS-ja edhe pyetjet e Trupit  
15 Gjykues, dëshmia e Dëshmitarit 04746 ka të ngjarë që të mos  
16 zgjasë deri të mërkurën apo të enjten e javës që vjen.

17 Prokuroria a ka ndonjë gjë për të thënë lidhur me këtë,  
18 domethënë, a mendon Prokuroria që mund të sjelli një tjetër  
19 dëshmitar.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të duhet që të përcaktohet,  
21 megjithatë, sikurse e thatë, mund të jetë e nevojshme për mua  
22 për të bërë pyetje plotësuese. Kështu që besoj që ky dëshmitar  
23 do të marrë pjesën më të madhe të javës që vjen.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptojmë. E  
25 kuptojmë që është një dëshmitar që ka shumë informacion, është

1 një dëshmitar që kërkon shumë kohë në sallën e gjyqit dhe ju  
2 të gjithë duhet të keni kohën tuaj.

3 Pra, kjo i takon që mbase mund të mos ketë kohë të  
4 mjaftueshme që të thërritet një tjetër dëshmitar dhe që të  
5 trajtohet tërësisht ai, kështu që dëshirojmë që t'ju japin  
6 disa informacione për sa i takon planifikimit dhe kjo jo për  
7 të cenuar përpjekjet organizative për të pasur një dëshmitar  
8 rezervë, megjithatë, në qoftë se Dëshmitari 04746 zgjat më  
9 tepër atëherë këto përpjekje do të ishin pa frute.

10 Kështu që për këtë arsye, Trupi Gjykues propozon që  
11 dëshmitar rezervë të mos thirret nga Prokuroria.

12 A jeni të gjithë dakord me këtë gjë?

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më tej Trupi  
16 Gjykues do japë një urdhër lidhur me kërkesën e Mbrojtësit të  
17 Viktimave sa i takon Dëshmitarit 04746.

18 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem na kaloni në seancë  
19 private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22 [Seancë e hapur] *Riklasifikuar si publik në bazë të*  
*Urdhrit Gojor të 19 korrikut 2023.*

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtësi i  
24 Viktimave i kërkoi leje Trupit Gjykues për ta pyetur  
25 Dëshmitarin 04746 me synimin për të nxjerrë sqarime sa i takon

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar si publik në bazë të Urdhrit Gojor të 19 korrikut 2023

Faqe 4

1           çështjeve të caktuara që kanë të bëjnë me interesat  
2           personalë të viktimave pjesëmarrëse në procesin gjyqësor.

3           Mbrojtja e kundërshtoi kërkesën lidhur me një prej dy  
4           viktimave pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, duke argumentuar  
5           që Mbrojtja e viktimave nuk dha njoftim në kohë për sa i takon  
6           kësaj kërkesë dhe duke parashtruar që kjo marrje në pyetje do  
7           të ishte cenuese për Mbrojtjen për sa i takon kundërpjetjeve  
8           të Mbrojtjes për dëshmitarin.

9           Trupi Gjykues vëren që Dëshmitari 04746 nuk është viktimë  
10          në këto procedura gjyqësore, duke shqyrtuar kërkesën e  
11          Mbrojtësi i Viktimave për të marrë në pyetje Dëshmitarin  
12          04746, Trupi Gjykues nuk është i bindur që sqarimet që  
13          dëshiron që të nxjerrë Mbrojtja e Viktimave nga dëshmitari në  
14          fjalë dhe nga për sa i takon viktimës [REDAKTUAR] nuk lidhet  
15          me interesat personalë të viktimave.

16          Së pari, Trupi Gjykues nuk është i bindur që kemi të  
17          bëjmë me dëmtim të reputacionit dhe pasoja të dëshmisë të  
18          dëshmitarit dhe kjo nuk vjen në fushën e interesit të  
19          viktimave që marrin pjesë në procesin gjyqësor për t'i lejuar  
20          Mbrojtjes së Viktimave për të bërë pyetje të një dëshmitari në  
21          përputhje me rregullën 114(4).

22          Së dyti, Trupi Gjykues mendon kryesisht se është  
23          përgjegjësia e ZPS-së që të nxjerrë sqarime dhe jo e Mbrojtjes  
24          së Viktimave sepse në këtë kontekst Mbrojtësi i Viktimave tani  
25          i kërkon që të nxjerrë informacione nga dëshmitari lidhur me

1 pjesëmarrjen e viktimave në procesin gjyqësor.

2 Trupi Gjykses më tej vëren se Dëshmitar 04746 në proceset  
3 tona për t'u pyetur për [REDAKTUAR] në fushën publike në këtë  
4 fazë është e papranueshme.

5 Për këto arsye, në përputhje me rregullën 114(4) në  
6 paragrafin 35 të Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor,  
7 Trupi Gjykses e rrëzon kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për  
8 të marrë në pyetje Dëshmitarin 04746 lidhur me [REDAKTUAR].

9 Duke marrë parasysh që Mbrojtjet nuk e kundërshtojnë  
10 pjesën tjetër të pyetjeve që kërkohen që të bëhen nga  
11 Mbrojtësi i Viktimave, Trupi Gjykses miraton lejen për pjesën  
12 tjetër të pyetjeve.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

1 jemi në seancë publike tani.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
3 Sekretare, sillni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

4 Znj. Prokurore.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ndërkohë që sillet dëshmitari,  
6 mbase është vendi që të bëj një propozim lidhur me provat  
7 materiale që synoj që të paraqiten në prova. Kam një listë të  
8 materialeve e cila është goxha e gjatë. Kështu në këtë rast  
9 specifik do të propozoja që ne të bëjmë një parashtrim të  
10 protokolluar të shkurtër në mënyrë që të rendisim të gjithë  
11 dokumentet që do të pranohen në prova materiale.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jam  
13 plotësisht dakord. Pra, Mbrojtja do të ketë mundësi që të  
14 rishikojë këtë listë të tuajin dhe ndërkohë mund të bëjë  
15 parashtrime me gojë kur të vijë momenti i përshtatshëm.

16 [Dëshmitari vijon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
18 uleni, Dëshmitar.

19 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

20 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot në  
22 mëngjes do fillojmë me kundërpjetet tuaja duke filluar me  
23 Mbrojtjen e z. Thaçi dhe më pas do të vazhdojmë me z.  
24 Emmerson, Mbrojtjen e z. Veseli dhe më pas me dy Mbrojtjet e  
25 tjera të të dy të akuzuarve të tjerë.

1 Z. Misetic, fjala është për ju. Ju lutem Dëshmitar  
2 përgjigjuni pyetjeve të z. Misetiç.

3 DËSHMITARI: W04746 [Vijon]

4 Pyetje të palës tjetër nga Z. Misetic:

5 Z. MISETIÇ [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjes, z. Mustafa. Unë jam Luca Misetic. Jam një  
7 ndër avokatët mbrojtës të z. Thaçi. Kam shumë pyetje për ju,  
8 kështu që ka të ngjarë që të gjithë ditën sot ta shpenzojmë me  
9 pyetjet për ju mbase edhe do të kemi pyetje edhe për të hënën,  
10 kështu që dua t'ju kërkoj për durimin tuaj dhe në qoftë se  
11 keni pyetje. Në qoftë se keni nevojë për sqarime ju lutem të  
12 ma thoni, unë e di që jeni jurist edhe vetë, por gjithsesi në  
13 qoftë se keni ndonjë pyetje, ndonjë paqartësi, mos hezitoni të  
14 më drejtoheni në mënyrë të tillë që pyetjet e mia të jenë të  
15 qarta në mënyrë që juve të jepni përgjigje të qarta. A e  
16 kuptoni këtë?

17 PË. E kuptoj.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do jemi  
19 nesër këtu.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] E kisha fjalën për të hënën në  
21 fakt.

22 PY. Z. Mustafa, dëshiroj që të fillojmë duke folur pak për  
23 vendin ku gjendej operative e Llapit. Zona operative e Llapit  
24 kishe një vijë kufitare të gjatë me Serbinë, kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Ju keni dhënë dëshmi mbi bazën e pyetjeve që ju dha  
2 Prokuroria që zona operative juaja përfshinte Podujevën,  
3 Obiliqin, Prishtinën dhe Fushë-Kosovën. A pajtoheni se të  
4 gjithë institucionet kryesore të Serbisë, pra, policia,  
5 administrata, paraushtarakët, a pajtoheni me faktin që të  
6 gjitha këto institucionet kryesore gjendeshin në zonën tuaj  
7 operative, në pjesën territoriale të zonës tuaj?

8 PË. Mund. Nuk jam i sigurtë, por meqë kryeqendra ishte  
9 Prishtina, mund me thënë që po.

10 PY. Ushtria e Jugosllavisë a e kishte selinë në Prishtinë? E  
11 kam fjalën selinë për Kosovën, ushtria e Jugosllavisë a e  
12 kishte në Prishtinë, shtabin për Kosovën, si me thënë?

13 PË. Ndoshta në Nish, ndoshta në Prishtinë nuk jam i sigurtë,  
14 por një garnizon ka qenë në Prishtinë.

15 PY. A ka pasur ndonjë MUP serb, pra, njësi të MUP-it serb në  
16 zonën tuaj?

17 PË. Po. Anembanë Kosovës ishne.

18 PY. A e dini në qoftë se njësitet paramilitare të Arkanit  
19 kanë qenë të vendosura në Hotel Grandin në Prishtinë?

20 PË. Po, kështu ka qenë.

21 PY. A ka pasur një njësit kundërinteligjence ushtarak  
22 jugosllav të pranishëm në Prishtinë, i quajtur KOS ndryshe?

23 PË. Po.

24 PY. Rruga kryesore e furnizimit nga Serbia për në Kosovë a  
25 kalonte nga Merdari?

1 PË. Një nga rrugët kryesore ishte Merdari.

2 PY. Merdar-Prishtinë. Po për linjën hekurudhore Prishtinë-  
3 Leskovac a ishte linja kryesore ose rruga kryesore e  
4 transportit përmes trenit për Jugosllavi?

5 PË. Po.

6 PY. Dje ju bënë shumë pyetje lidhur me luftën speciale. A  
7 jeni në dijeni që institucionet serbe në zonën tuaj dhe jashtë  
8 zonës tuaj kanë qenë të përfshirë në një luftë propagandistike  
9 kundër UÇK-së?

10 PË. Aparati i shtetit serb me gjithë kapacitetin e tij ka  
11 qenë i angazhuar me luftë kundër popullatës shqiptare dhe  
12 neve.

13 PY. Kjo luftë propagandistike, pra, ishte në nivel të  
14 Jugosllavisë edhe në nivel ndërkombëtar, kështu ka qenë?

15 PË. Ne i luftonim si forca serbe.

16 PY. Po. Por po pyes në qoftë se keni qenë në dijeni që  
17 Serbia, për shembull, ka qenë e përfshirë në përpjekje  
18 propagandistike për ta etiketuar UÇK-në si, për shembull,  
19 terrorist?

20 PË. Po.

21 PY. Është si fundamentalist islamik?

22 PË. Edhe kjo ka qenë një prej nga propagandat. Nuk ka dhezë  
23 shumë.

24 PY. Këto institucione serbe në zonën tuaj, a kishin  
25 bashkëpunëtorë që ishin, që funksiononin brenda zonës tuaj?

1 PË. Ka mund të ketë, por nuk kishte numrin që ne e kemi  
2 vërejt më shumë. Në atë kohë shqiptarët në përgjithësi kanë  
3 qenë të shkoqur nga aparati shtetëror serb, kështu që ka qenë,  
4 mund të ndodhë që ka pasë, por ka qenë në vështirësi që  
5 identifikohen.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që të paraqitet në ekran  
7 prova materiale P00223.

8 PY. Pyetja e parë është kjo. A pajtoheni me mua që lufta e  
9 UÇK-së ishte më shumë propagandistike sesa operative?

10 PË. Pajtoj.

11 PY. Dhe, në fakt, forcat e armikut kishin mundësi që të  
12 futeshin në çdo pjesë të zonës tuaj kudo që ata dëshironin, a  
13 është e saktë, kjo?

14 PË. Po, e saktë është.

15 PY. Pra, kjo vija që keni bërë në këtë hartë, nuk është vijë  
16 mbrojtjeje, kështu? Sepse forcat serbe mund të futeshin përmes  
17 kësaj vije në çdo moment që ta vendosnin ata, është e saktë  
18 kjo?

19 PË. Është vijë mbrojtëse, por jo e pathyeshme nga ana armike.  
20 Ata kanë hy kurdo që kanë tentu ose seriozisht me hy. Ne  
21 s'kemi mujt me pengue me çdo kusht.

22 PY. Në rregull. Faleminderit. Ju keni qenë luftëtar, qëllimi  
23 kryesor i të cilit ka qenë për arritjen e pavarësisë së  
24 Kosovës, a është e vërtetë kjo?

25 PË. Po.

1 PY. Ju keni qenë dikush ku objektivi për pavarësinë Kosovës  
2 nuk mund të komprometohej ose nuk mund të negociohej për asnjë  
3 gjë në botë, kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Ju nuk pranoni asnjë plan paqeje që nuk e përfshinte të  
6 paktën të drejtën e Kosovës për të qenë ose për të kërkuar  
7 pavarësinë në një pikë të caktuar kohe në të ardhmen, kështu?

8 PË. Ashtu ishte.

9 PY. Në rregull. T'ju bëj një pyetje tjetër tani. A keni marrë  
10 ndonjëherë ndonjë urdhër nga Azem Sylja?

11 PË. Jo, zotëri.

12 PY. E me këtë pyetje e kisha fjalën që a ke marrë ndonjëherë  
13 ndonjë urdhër me shkrim apo me gojë nga Azem Sylja?

14 PË. Asnjëherë.

15 PY. A keni marrë ndonjëherë urdhër nga dikush që pretendonte  
16 se të jepte një urdhër për llogari të Azem Sylës që  
17 pretendonte, që vepronte për llogari të Azem Sylës?

18 PË. Ne as që e kemi ditë që është pozicion të rëndësishëm  
19 Azem Sylja deri në kohën e Rambujesë.

20 PY. Në rregull. Është e drejtë të themi që deri në shkurt të  
21 1999, ju keni pasë përshtypjen se nuk ka pasë ndonjë komandant  
22 të përgjithshëm të UÇK-së, pra, deri në shkurt të 1999  
23 përshtypja ishte që s'ka pasë ndonjë komandant të përgjithshëm  
24 UÇK-ja?

25 PY. Po deri sa kemi vendos për Sylejman Selimin të jetë

- 1 komandant, unë, për mua s'më ka qenë e njohur se është një  
2 komandant i UÇK-së.
- 3 PY. Pra, është e drejtë të themi që nuk ka pasë komandant mbi  
4 ju në UÇK? Ka pasë komandant në nivele të barabarta dhe këta  
5 ishin komandantët e zonave, kështu?
- 6 PË. Ashtu ka qenë.
- 7 PY. Dhe kur folëm dje për Rambujenë, komandantët e zonave  
8 ishin ata që do t'i jepnin pëlqimin Shtabit të Përgjithshëm që  
9 të shkonte delegacioni i UÇK-së në Rambuje, kështu?
- 10 PË. Kështu ka ndodhur.
- 11 PY. Dhe po ashtu komandantët e zonave në shkurt të 1999  
12 emëruan Sylejman Selimin sepse ju mendonit se nuk kishe  
13 komandant UÇK-ja, kështu?
- 14 PË. Po.
- 15 PY. Një nga shqetësimet tuaja sa i takon negociatave të  
16 Rambujesë ishte pikërisht fakti se do të përfundonin ose do të  
17 dilnin me një marrëveshje për autonomi por jo pavarësi,  
18 kështu?
- 19 PË. Po. Ne nuk ndiheshim mirë në atë kohë me delegacionin e  
20 Rambujesë dhe nuk mund ta kisha besimin sikur e kam pasë më  
21 vonë.
- 22 PË. Po sikurse thashë fillimisht, ju ishit dikush, ishit një  
23 person që donit pavarësinë e Kosovës dhe për rrjedhojë kur  
24 doli ky shqetësimi që do ketë negociata, po ama me këtë  
25 negociatë s'do fitojmë pavarësinë, kjo ju shkaktoi disa

1 shqetësime apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. A është e vërtetë që Sylejman Selimi u emërua nga  
4 komandantët e zonave që të ishte komandant i përgjithshëm i  
5 UÇK-së dhe t'i përcillte mesazhin delegacionit në Rambuje dhe  
6 t'u thoshte se tashmë kishte një komandant dhe do të duhet të  
7 ktheheshin në Prishtinë që të merrnin miratimin për çdo pikë  
8 për të cilën do pajtoheshin apo do binin dakord në Rambuje,  
9 kështu?

10 PË. Mund të themi që ka qenë presion mbi delegacionin tonë që  
11 të kthehet dhe të merret vesh me ne dhe të ishte më i vendosur  
12 në objektivat tona në pavarësinë e Kosovës.

13 PY. Po ju, komandantët e zonave, që qëndruat në Kosovë donit  
14 t'i thonit delegacionit në Rambuje: Ne duam pavarësinë e  
15 Kosovës dhe duhet të merrni miratimin tonë për këtë?

16 PË. Po. Po.

17 PY. A ishit në dijeni aso kohe që delegacioni shqiptar  
18 përfshinte z. Thaçi, z. Krasniqi, z. Sylja, z. Haliti dhe Ramë  
19 Bujën, krahas z. Rugova. I dinit që ishin dhe këta të tjerët?

20 PË. Po.

21 PY. Është e vërtetë që komandantët zonave e kuptuan apo e  
22 dinin se ata ishin personat që kishin kompetencën për të  
23 emëruar komandantin e përgjithshëm të UÇK-së, kështu?

24 PË. Nuk jam i sigurtë se e kemi ditë të gjithë, po ne kemi  
25 dashtë të bëjmë diçka për të mirën e vendit tonë.

1 PY. Nëse ju emëruat atë, ju besonit që ju e kishit pushtetin  
2 apo kompetencën për ta emëruar atë, apo jo?

3 PË. Ne nuk mendonim dikën më kompetent se ne. Ashtu.

4 PY. Ju emëruat, pra, ju komandantët e zonave emëruat Sylejman  
5 Selimin si komandantin e përgjithshëm të UÇK-së në shkurt të  
6 1999, saktë?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe, në fakt, Sylejman Selimi u bë komandanti i  
9 përgjithshëm i UÇK-së për shkak të vendimit që u mor nga  
10 komandantët e zonave, kështu?

11 PË. Po.

12 PY. Në një ushtri, Shtabi i Përgjithshëm i raporton  
13 komandantit të Përgjithshëm, kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Për shembull, në zonën tuaj shtabi juaj ju raportonte ju,  
16 a është e saktë?

17 PË. E saktë.

18 PY. Dhe në momentin që u emërua Sylejman Selimi si komandant  
19 i përgjithshëm, personeli apo personat në Shtabin e  
20 Përgjithshëm do të donin t'i raportonin Sylejman Selimit, a  
21 është kështu?

22 PË. Po.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të shohim tani një libër të  
24 cilin jua kam treguar disa herë. Është libri "Komandant Remi  
25 flet". Është SPOE000533007 anglishtja dhe SPOE00330271

1 shqipja, faqja 85.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të na jepni  
3 numrin e plotë të shqipes, ju lutem?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] SPOE00330195 deri në 00330361  
5 PY. Z. Mustafa, po shoh këtu pyetjen.

6 "Ku fillon ku mbaheshin takimet e komandanteve të zonës  
7 në atë kohë? Kush merrte pjesë në mbledhje dhe zakonisht cila  
8 ishte rrjedha e tyre?"

9 Dhe ju përgjigjeni:

10 "Takimet mes komandantëve të zonave kanë qenë të shpeshta  
11 dhe të nivelit."

12 Sa shpesh takoheshin komandantë e zonave? Këtu thua që  
13 kanë qenë të shpeshta, po kur thua të shpeshta, sa "shpesh" e  
14 ke fjalën?

15 PË. Për mua prej një anë të Kosovës në anën tjetër e shpeshtë  
16 ka qenë nëse ka qenë mujore.

17 PY. Pra, kishte takime mujore të komandantëve të zonave?

18 PË. Ndoshta mundet me thënë mujore për arsye se nga vendi ku  
19 unë kisha shtabin deri te Shtabi i Përgjithshëm, ka mund me  
20 ndodhë që ka shkuar java dhe për rrugë, udhëtim.

21 PY. Kur filluan këto takime?

22 PË. Këto takime janë -- të kompletuara kanë filluar edhe para  
23 rënies së komandantit Adem Jashari. Por takime të rregullta  
24 pas ardhjes së Bislime Zyrarit shef i Shtabit të Përgjithshëm  
25 dikun në korrik, mendoj, gusht kanë fillue të mbahen kurse në

1 nëntor, dhjetor, mendoj, që kanë qenë më të shpeshta dhe më të  
2 organizuara.

3 PY. Ju kujtohet kur u bë shef shtabi Bislim Zyrapi?

4 PË. E di që është bërë, por nuk më kujtohet koha.

5 PY. Nëse po flisni për takimet me Bislim Zyrapin, ku ai  
6 kryesonte këto takime si shef shtabi apo këto mbledhje, a  
7 është e drejtë të themi që këto takime apo këto mbledhje, pra,  
8 këto takime të komandantëve të zonave që kryesonte Bislim  
9 Zyrapi filluan në nëntor apo në dhjetor sepse atëherë u emërua  
10 dhe Bislim Zyrapi, është e drejtë të themi që filluan në këtë  
11 periudhë?

12 PË. Është e drejtë.

13 PY. Vazhdojmë me tekstin. Fjalja e tretë.

14 "Pa marrë parasysh faktin se shumë herë kemi ardhur në  
15 pozita të palakmueshme, qoftë si Ushtri Çlirimtare e Kosovës  
16 ose si zonë diku, vendimi për bisedat e zhvilluara me  
17 ndërkombëtarët që në fund vendosën t'ia linin Shtabit të  
18 Përgjithshëm të UÇK-së dhe ndihma reciproke e njeri-tjetrit në  
19 momente të vështira si për furnizim me armatim, si për kalim  
20 të njerëzve nga një zonë në tjetrën, tregon se ne kemi  
21 bashkëpunuar mirë, i kemi ndihmuar njeri-tjetrit".

22 Ju po thoni këtu, z. Mustafa që komandantët e zonave  
23 ishin pikërisht ata që vendosën t'ia linin bisedat me  
24 ndërkombëtarët Shtabit të Përgjithshëm, kështu?

25 PË. Kështu ka ndodhë.

1 PY. z. Mustafa, a ju kujtohet që ju ka marrë në intervistë

2 BBC-ja shkurtimisht pas luftës për një dokumentar?

3 PË. Ka pasë atëherë interesim shumë për komandant zone. Ka

4 ndodhë, me siguri ka ndodhë. Nuk më kujtohet veçantë diçka por

5 e di që shumë nga revistat e huaja më kanë intervistuar.

6 PY. Do ju tregoj një video nga kjo intervistë. Është disi e

7 gjatë, por thjesht kushtoi pak rëndësi sepse në fund do ju bëj

8 një pyetje nëse gjërat që ke thënë në këtë video janë të saktë

9 dhe të vërteta, me aq sa ju kujtohet dhe me aq sa besoni ju,

10 apo ka ndonjë gabim aty që doni ta korrigjoni, prandaj ju

11 lutem dëgjoheni me vëmendje dhe të na thoni të fund nëse ka

12 diçka që doni ta korrigjoni.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] nëse mund të vendosni ju lutem

14 DHT001151.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare,

16 ndihmoheni dëshmitarin me këtë video që ta shoh sa më mirë

17 sepse duket sikur e ka pak larg. Rregullojeni pak ekranin.

18 Dëshmitar, e shihni në ekran?

19 DËSHMITARI: Po.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 [Luhet videoincizimi]

22 "Intervistuesi: [Përkthim] Më thoni jeni pro apo kundër

23 Rambujesë? Çfarë argumentesh keni për të mbështetur qëndrimin

24 tuaj? Më trego a ke qenë pro apo kundër shkuarjes në Rambuje

25 dhe si e ke argumentu qëndrimin tënd?

1 "Z. Mustafa: Kam qenë pro shkuemjes në Rambuje, por kam  
2 qenë në fillim jo për nënshkrim, po veç për me shku dhe me  
3 thënë kërkesat tona që janë atje.

4 "Intervistuesi: [Përkthim] --

5 [Anëtarët e Trupit Gjykes dhe Sekretarja e

6 Gjykatës këshillohen]

7 [Luhet videoincizimi]

8 "Intervistuesi: [Përkthim] [Folës që flasin njëkohësisht]  
9 ajo që ju thatë që nuk duhet me bë aprovimin si në Dejton që e  
10 kemi bë?

11 "Z. Mustafa: Jo".

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Na ndaloni për një çast. Kemi dhe  
13 transkriptin në fakt dhe do t'i shërbente palëve dhe Trupit  
14 Gjykes që ta ndjekin edhe ata se çfarë po thuhet në video,  
15 kështu që do të shpërndaj transkriptin.

16 Të njëjtin numër DHT001151-TR.

17 Ktheheni dhe një herë nga fillimi videon se videoja e  
18 parë është kjo.

19 [Luhet videoincizimi]

20 "Intervistuesi: [Përkthim] Më trego a ka qenë pro apo  
21 kundër shkuarjes në Rambuje dhe si e ke argumentu qëndrimin  
22 tënd?

23 "Z. Mustafa: Kam qenë pro shkuemjes në Rambuje, por kam  
24 qenë në fillim jo për nënshkrim, po veç për me shkue dhe me  
25 thënë kërkesën tona që janë atje.

1 "Intervistuesi: [Përkthim] [Folës që flasin njëkohësisht]  
2 ajo që ju thatë që nuk duhet me bë gabimin si në Dejton që e  
3 kemi bë?

4 "Z. Mustafa: Jo.

5 "Intervistuesi: [Përkthim] Një minutë. [E pakuptueshme]  
6 ju kujtohet që herën e kalume na ke thënë që nuk ke mujt me  
7 shku në takim me jap përkrahjen për të shkuarjen në Rambuje,  
8 por ke thirr me telefon dhe ke thënë ju përkrahim shkoni, po  
9 shkoni vetë veshun me uniforma që bë deklarim që qe erdhëm nga  
10 UÇK-ja. Edhe ju ke thënë mos u mashtroni, mos ju besoni.

11 "Z. Mustafa: Po, normalisht.

12 "Intervistuesi: [Përkthim] A mundesh me tregu pak prej  
13 fillimit?

14 "Z. Mustafa: Po është e vërtetë. Ne s'kena mujt me shku  
15 në takim sepse ka qenë luftë dhe shumica e komandantëve s'kena  
16 mujt me prezencën tonë me thënë. Mirëpo ne kena folë përmes  
17 telefonit dhe ju kemi thënë se normalisht se duhet me shkue në  
18 Rambuje, duhet me shku me uniformë të veshun të UÇK-së, me  
19 armatë me armë, taman qysh duhet me shkue. Me prezantue  
20 qëllimet e tona. Mirëpo kush qysh guxoni me ju mashtru, nuk  
21 bën me u tradhtue dhe duhet na me fitu atje jo me na mashtru.

22 "Intervistuesi: [Përkthim] Ndërkohë derisa ka qenë  
23 delegacioni në Rambuje, ti ke dëgjju dhe ke dëgjju që ka gjasa  
24 që ata mund të mashtrohen. Në bisedat telefonike që i ke pasë  
25 me ta çka ju ke thanë? Edhe bëni pushtet, domethënë, më

1 parafytyro mu si person si person me të cilin do të mund ta  
2 nënshkruani atë marrëveshje?

3 "Z. Mustafa: Po i kemi marrë telefonatat edhe i kemi  
4 marrë në telefon të gjithë anëtarët e grupit negociator që  
5 janë kanë aty dhe ju kemi kërcënu. Dhe nuk guxoni me  
6 nënshkrue. Ajo nuk është marrëveshje për të cilën ju keni shku  
7 me fol. Nuk keni drejtë. Edhe në rast se e nënshkruani nuk  
8 guxoni me u kthy në Kosovë. E i vuna në presion  
9 jashtëzakonisht të madh edhe e kanë, domethënë, kemi thënë që  
10 duhet me u kthy kahu për me ardhë te na. Pastaj me shkue edhe  
11 normalisht janë shkue në Rambuje. Të njëjtën gjë kanë votu për  
12 Kosovë për me shku prapë me nënshkrue.

13 "Intervistuesi: [Përkthim] Kur ma ke thënë këtë fakt  
14 herën e kalume më ke thënë që ju këtë person tuj thanë që [e  
15 pakuptueshme] më ke ju [folës që flasin njëkohësisht]. Pyes  
16 nëse mundesh me të thanë në vetë parë, unë ju kam, megjithëse  
17 kur përkthehet ndoshta e kena bë.

18 "Z. Mustafa: Po. Gjatë kohës sapo zhvillohej Rambujeja,  
19 na kishim informata që ata po dojnë me nënshkru në një  
20 marrëveshje e cila neve nuk na konvenonte. Po na, në mënyra të  
21 ndryshme, kam marrë telefonin, i kam telefonue edhe e kemi bë  
22 -- kam bë kërcnim "Nuk guxoni me nënshkrue". Dhe më kujtohet  
23 si sot njënit prej tyre i kam thënë që ju e dini se kemi  
24 raketa kundër ajrit dhe do t'i ruajmë ato raketa s'do t'i  
25 përdorim me serbë, po në aeroplan me ju po zbritën në Slatinë

1 do ta rrëzojmë nëse e nënshkruani. Normalisht, ata e kanë punu  
2 ashtu. Janë ardhë këtu në Kosovë me u konsultu me ne. Ja kam  
3 thënë edhe po kujtohet ose ky rasti tjetër se sapo i kish  
4 marrë dikujna [folës që flasin njëkohësisht].

5 "Intervistuesi: [Përkthim] A ke diskutu me Demaçin për  
6 Rambujenë se dhe ai ka qenë --

7 "Z. Mustafa: Po.

8 "Intervistuesi: [Përkthim] -- se dhe ai ka qenë shumë i  
9 brengosur? Po atëherë çfarë ka të thanë ai ty për apo çka i ke  
10 thënë ti atij?

11 "Z. Mustafa: Adem Demaçi ka thënë që kjo është konferencë  
12 që është gabim për shqiptarët. Nuk kanë me mujt me arrit atë  
13 çka është dashtë me arrit, po do të arrihet për referendumin.  
14 Dhe normalisht që dhe unë i kam besue. Se kjo ka qenë diçka  
15 skeptike dhe kjo marrëveshja e Rambujesë derisa është  
16 realizue. Dhe Adem Demaçi nuk ka qenë i kënaqur absolutikisht  
17 me Rambujenë, as me delegacionin që ka shku dhe forma qysh  
18 është prezantu problemi jonë atje. Kemi bisedu shumë me Adem  
19 Demaçin. Edhe Adem Demaçi atëherë ka përvendos me u tërheq pej  
20 drejtorisë politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

21 "Intervistuesi: [Përkthim] Kur ju kthy delegacioni  
22 shqiptar për me [e pakuptueshme] ka qëndru dy javë në Kosovë  
23 veç kur janë pezullu bisedimet në Rambuje e pastaj janë shku  
24 në Paris, a mundet të na tregosh për bisedat që i keni pasur  
25 të kësaj natyre nënshkruar apo jo dhe për çfarë ju ka thënë

1 Thaçi, besoj që ka thënë se serbët nuk do të nënshkruajnë?

2 "Z. Mustafa: Kanë qenë bisedime këto ma të gjata aty në  
3 Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kemi  
4 qenë prezent të gjithë komandantët e zonë edhe kemi diskutuar  
5 shumë gjatë. Shumica janë kanun prej nesh, kanë qenë për mos  
6 me e nënshkru dokumentin. Mirëpo besoj që ke ditë Thaçi bashkë  
7 me Jakup Krasniqin, e kanë thjeshtësuar shumë mirë dhe na kanë  
8 sigurie sidomos me emrin e znj. Albright, me emrin e shumë  
9 njerëzve që vinin në atëkohë të NATO-s, të Clark e gjeneralëve  
10 të tjerë që baje ke, gjoja se ke mbaranca shumë prej tyne na  
11 kanë sigurue për ne me dhanë na po-në tonë për shku për me  
12 asi. Më së shumti na kemi kemi qenë të -- janë mundu me na  
13 bind se serbët nuk do ta nënshkruajnë dokumentin. As ne nuk  
14 kemi besue, nuk kemi mujt me besue se Serbia nuk do ta  
15 nënshkruake. Dhe na kemi qenë të kënaqur me mosnënshkruarjen e  
16 Serbisë, e palës serbe nënshkrimin e dokumentit. Thaçi me  
17 mjeshtëritë e veta na ka bind dhe të gjithë ja kemi dhënë "po-  
18 në" dhe delegacioni shqiptar kur është shkue në Rambuje është  
19 shku për me nënshkrue mbasi që të gjithë jemi konsultu dhe të  
20 gjithë i kemi thënë po.

21 "Intervistuesi: [Përkthim] Në të gjithë atë kohë me arsye  
22 ke qenë i brengosur se serbët këtë do ta nënshkruajnë?

23 "Z. Mustafa: Po unë ja kam thënë dhe aty delegacionit i  
24 kam thënë unë s'do të prishi punë. Unë mendoj që është keq me  
25 shku në Rambuje se edhe sepse ata do ta nënshkruajnë, por nuk

1 jam tu besu mirë dhe s'do dalë publikisht dhe nuk dalë me  
2 deklarata në opinion që nuk e njoh që unë jam kundër. Kësaj  
3 radhe mbase jemi të gjithë për këtë për punë, do të jem dhe  
4 unë. Kjo ka qenë problemi rreth meje. Mirëpo edhe unë në fund  
5 ju kam garantu që s'do të prishi punë në këtë marrëveshje".

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Z. Mustafa, arrite ta ndiqje çdo gjë që u tha në video?

8 PË. Po.

9 PY. Gjërat që keni thënë në këtë video janë të vërteta dhe të  
10 sakta me aq sa dini dhe besoi ju?

11 PË. Po.

12 PY. Faleminderit. Në video thatë se z. Thaçi u kishte thënë  
13 komandantëve të zonave, u kishte dhënë garanci që ua kishte  
14 dhënë Madeleine Albright dhe Gjenerali Clark. A ju kujtohen  
15 çfarë garancish ju dha?

16 PË. Z. Hashim Thaçi, tani më ishte shefi i delegacionit të  
17 Rambujesë. Ka bë gjithçka për me na bind. Nuk mund të kthehem  
18 prapa dhe të di krejt çka, po e di që ka arrit me na bind një  
19 nga një. E kemi dit se ka kontaktuar me njerëzit më të  
20 fuqishëm të kohës të globit, kemi pasë siguri se ai po  
21 kontakton me njerëz të rëndësishëm dhe ne s'kemi mujt me i ik  
22 besimit që na ka jap në atë kohë. Unë kam qenë skeptik derisa  
23 ka fillu bombardimi i NATO-s. Mirëpo jam pajtu.

24 PY. Është e saktë që z. Thaçi, z. Krasniqi, z. Buja dhe të  
25 tjerët ata duhej që të merrnin miratimin tuaj dhe të

1 komandantëve të tjerë të zonave në mënyrë të tillë që të mund  
2 të nënshkruanin në Rambuje. Ka qenë kështu?

3 PË. A pajtoheni me mua se kjo ishte për shkak të faktit se z.  
4 Thaçi, kishte autoritet ose kompetencë vetëm nga fakti që  
5 kishte mbështetjen e komandantëve të zonës, e saktë kjo?

6 PË. Ndryshe nuk do të mundte ta nënshkruante as z. Thaçi.

7 PY. Në rregull. Po them që kompetenca apo autoriteti i z.  
8 Thaçi në UÇK vjen deri në masën që atij i jepet pëlqimi nga  
9 komandantët e zonave që të nënshkruanin në emër të tyre, këtë  
10 po them?

11 PË. Po.

12 PY. Dhe në qoftë se komandantët e zonës do e tërhiqnin  
13 pëlqimin ose do e tërhiqnin kompetencën apo pushtetin që i  
14 kishit dhënë z. Thaçi, z. Thaçi nuk do të kishte mundësi të  
15 bënte ndonjë gjë tjetër në Rambuje, kështu?

16 PË. Besoj ashtu do të ishte. S'do të kishte kuptim  
17 marrëveshja pa ne. Nuk do të mund të bëhej në fakt.

18 PY. Faleminderit.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, dua të paraqes  
20 videon e BBC si provë materiale, pra, është prova materiale  
21 DHT001151 dhe transkriptin përkatës që sapo e pamë që është  
22 DHT0051-TR.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Lawson.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Videoja dhe transkripti do të pranohen si prova materiale.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do  
3 të marrin numrin e provës materiale 1D24.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Z. Mustafa, dëshiroj t'ju tregoj një pjesë të një libri  
7 të shkruar nga kolegu juaj nga z. Haradinaj dhe do t'ju pyes  
8 në qoftë se pajtoheni me atë çfarë ka thënë ai apo jo?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, është një fragment nga libri  
10 "Një rrëfim rreth luftës dhe lirisë". Është dokumenti me numër  
11 ERN U0717-6046 dhe U017-6049. Në faqen U017-0648 në gjuhën  
12 angleze dhe versioni në gjuhën shqipe është KSC-BC-2020-06-IT-  
13 05-87 3D00375 në faqen 3D00-4382. Ju kërktoj ndjesë është shumë  
14 shifra, Gjykatës.

15 Faqja është U017-6048

16 PY. Pyetja që i bëhet z. Haradinaj në këtë libër ka të bëjë  
17 me z. Demaçi dhe rolin e tij sa i takon marrëveshjes së  
18 Rambujesë. Pyetja është kjo:

19 "Gjatë konferencës së Rambujesë, z. Sylejman Selimi u  
20 caktua komandant i përgjithshëm i UÇK-së".

21 Tani, le të shohim bashkërisht përgjigjen që jep z.  
22 Haradinaj sepse Sylejman Selimi ishte caktuar komandant i  
23 përgjithshëm. Nga mesi i paragrafit thuhet që nuk mund të them  
24 që ishte tërësisht pa vlerë sepse qëndrimi i Demaçit nuk ishte  
25 i vendosur dhe ne luftonim si luftëtarë dhe diçka tjetër duhet

1 të merret parasysh në këtë rast: Jakup Krasniqi, zëdhënësi i  
2 Shtabit të Përgjithshëm, z. Thaçi, drejtori i drejtorisë  
3 politike të UÇK-së, Ramë Buja, Azem Syla dhe Xhavit Haliti  
4 ishin të gjithë të pranishëm në Rambuje. Që të gjithë këta  
5 janë ana politike e UÇK-së. Në anën tjetër, ushtria nuk mund  
6 të funksionojë pa pasur një hierarki. Ushtria nuk është një  
7 shoqatë apo asociacion ku të gjithë kanë të drejta të  
8 barabarta. Në ushtri, njëri flet e të tjerët veprojnë.

9 "Domethënë, komandimi është i domosdoshëm për punë."

10 Dhe vazhdon më tej paragrafi.

11 Pyetja e parë është kjo që a jeni dakord me faktin që  
12 zonat operative funksiononin më vete dhe funksiononin me  
13 logjikën e ushtarëve, të luftëtarëve dhe qytetarëve të Kosovës  
14 gjithmonë?

15 PË. Po.

16 PY. A pajtoheni se ndërmjet të tjerave, z. Thaçi, z. Krasniqi  
17 ishin ana politike e UÇK-së?

18 PË. Ajo tanimë veç dihet.

19 PY. Në rregull. Arsyeja sipas z. Haradinaj të paktën që z.  
20 Sylejman Selimi u caktua komandant i përgjithshëm ishte që  
21 deri në atë pikë nuk kishte një komandant të vetëm, domethënë,  
22 një komandë i cili ishte mbi ose në hierarki ishte më sipër  
23 sesa komandantët e zonave, a është e saktë kjo?

24 PË. Pothuajse të gjithë e kemi dit kështu. E saktë.

25 PY. Në rregull. Sylejman Selimi u caktua komandant i

1 përgjithshëm i UÇK-së sepse ana politike e UÇK-së nuk ishte  
2 përgjegjëse për aspektin ushtarak të UÇK-së, e saktë kjo?

3 PË. E saktë.

4 PY. A është e drejtë të themi se komandantët e zonës caktuan  
5 Sylejman Selimin që më pas do të raportonte për komandantët e  
6 zonave do të jepte llogari përpara komandantëve të zonave,  
7 është e saktë kjo?

8 PË. Po.

9 PY. Dje, ju bënë pyetje nga Prokuroria lidhur me kohën kur ju  
10 vetë keni qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Juve nuk ju  
11 pëlqeu ajo çfarë gjetët në Shtabin e Përgjithshëm kur shkuat  
12 në Shtabin e Përgjithshëm, kështu?

13 PË. Ashtu është.

14 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses se cilat ishin ato  
15 kushte ose aspekte të Shtabit të Përgjithshëm që nuk ju  
16 pëlqyen ju asokohe?

17 PË. Nuk kishte resurse. Nuk e dëgjonte askush askënd dhe nuk  
18 kishe ku të drejtoheshe për gjërat elementare. Unë nuk mund ta  
19 bëja punën time në ambientin që e gjeta aty dhe nuk doja të  
20 vazhdoja të rri me male pa bërë asgjë.

21 PY. z. Mustafa, mua më kanë thënë që ju jeni punëtor i madh,  
22 a është e vërtetë kjo?

23 PË. Unë, sidomos gjatë luftës, po edhe pas luftës sa kam qenë  
24 ushtar jam mundue të bëj punët si duhet. Kam qenë i rregullt.

25 PY. Dhe jeni person shumë i organizuar, kështu?

1 PË. Ashtu përpiqem të jem.

2 PY. A do ishte e drejtë të thuhet se ajo çfarë gjetët kur  
3 shkuat në Shtabin e Përgjithshëm në shtab, pra, ishte shumë  
4 herë më i çorganizuar krahasimisht me organizimin që kishit  
5 bërë juve në zonën operative të Llapit?

6 PË. Asbsolutikisht po.

7 PY. Dhe më pas pra, kur nuk ishit i kënaqur me kushtet në  
8 Shtabin e Përgjithshëm, thjesht vendosët personalisht që të  
9 ktheheshit mbrapsht tek komanda e zonës operative të Llapit,  
10 kështu?

11 PË. Po.

12 PY. Të bëj këtë pyetje: A e ricaktuat veten komandant të  
13 zonës së Llapit apo në të njëjtën kohë mendohej që ju të ishit  
14 dhe komandant i zonës së Llapit edhe të punonit në Shtabin e  
15 Përgjithshëm?

16 PË. Vendi nuk ishte plotësuar ende dhe unë vetëm u ktheva në  
17 vendin tim. Nuk ka pasë dikush që mundet me më thënë jo në atë  
18 kohë. Shtabi të cilin unë e udhëheqja e mirëpritën kur po  
19 kthehesha. Kurse me Shtabin e Përgjithshëm nuk kam pasë as  
20 arsye as pse të diskutoj këtë çështje, vetëm i kam bërë të  
21 ditur që unë nuk mundem me qëdru aty. Nuk do të qëndroj më.

22 PY. Pra, thjesht i thatë Shtabit të Përgjithshëm që e  
23 ndryshova planin dhe do ktheheshe në zonë dhe Shtabi i  
24 Përgjithshëm nuk bënte dot asgjë lidhur me këtë vendim tuajin  
25 kështu?

1 PË. Nuk mundet. Nuk mund të bënte asgjë edhe po të donte.

2 PY. Në rregull. Sapo thatë që:

3 "...unë u ktheva në pozicionin tim të mëparshëm dhe  
4 askush nuk guxonte të më thoshte ndryshe".

5 E saktë është kjo?

6 PË. Nuk kishte autorizim. Ne nuk kishim komandant. Ne ishim  
7 njerëz që flisnim ndër vedi, mundoheshim të organizoheshim por  
8 askush s'kishte autoritet të më thonte mu bëje këtë kështu.

9 PY. Dakord, pajtohem. Por a nuk ishte rasti që eshë  
10 brendapërbrenda zonës së Llapit ju kishit mbështetjen e  
11 njerëzve dhe personave ose komandantëve në nivelin më të ulët  
12 të zonës, domethënë, ju ishit, si me thënë autoriteti ose  
13 personi që kishit pushtetin më të madh në zonën operative të  
14 Llapit, është e saktë kjo? Ose ndoshta do ta bëj ndryshe  
15 pyetjen.

16 Luftëtarët në zonën e Llapit, bashkëluftëtarët tuaj, pra,  
17 ju të gjithë ishit të ndershëm me njeri-tjetrin, të çiltër me  
18 njëri-tjetrin, kështu?

19 PË. Po. Ata u gëzuan që u ktheva unë dhe e mirëpritën.

20 PY. Në këtë kontekst, z. Mustafa, dëshiroj që të kthehem  
21 përsëri në fillim, pra, për atë që trajtova në fillim fare të  
22 kundërpjetjeve ndaj jush, që ka të bëjë me mënyrën sesi ishte  
23 organizuar zona juaj dhe sesi ndodhi që ju të mbanit ato post  
24 që keni mbajtur në zonën operative të Llapit në shkurt të  
25 1999.

1 Atëhere dua që të mendoni tani për 1995. Sepse janë  
2 pyetje që do të vendosin, si me thënë, historikun ose do të  
3 jenë themelore. Domethënë, në vitin 1995 ju keni qenë pjesë e  
4 rinisë së LDK-së, a është e saktë kjo?

5 PË. Po.

6 PY. Dhe jeni larguar në LDK në vitin 1996 kur Adem Demaçi  
7 formoi partinë e vet, PPK-në, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Në atë kohë UÇK-ja, pra, UÇK-ja drejtuesi, udhëheqësi i  
10 UÇK-së ë zonë ka qenë Zahir Pajaziti, e saktë është kjo?

11 PË. Po.

12 PY. Zahir Pajaziti ka pasur ose ka qenë në gjendje që të  
13 sigurojë armë nga Shqipëria dhe nga zona e Dukagjinit në atë  
14 kohë, e saktë?

15 PË. E saktë.

16 PY. Më 31 dhjetor 1997, Zahir Pajaziti u vra mbas një  
17 shkëmbimi zjarri, mbas një luftimi me forcat serbe, a është e  
18 saktë kjo?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe pas vrasjes së tij ka pasur një periudhë kohe ku UÇK-  
21 ja në zonën operative të Llapit duhej që të ristrukturohej,  
22 është e vërtetë kjo?

23 PË. E vërtetë.

24 PY. Dhe ju dhe Sejdi Rama filluat që të kontaktonit me  
25 bashkëluftëtarët të tjerë, e vërtetë kjo?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe rreth kësaj kohe, pak a shumë, ju po kërkonit të  
3 gjenit ushtarë të rinj të UÇK-së në mënyrë të tillë që t'i  
4 bashkoheshin luftës, kështu?

5 PË. Ashtu ishte.

6 PY. Dhe njëri prej këtyre personave që keni rekrutuar në  
7 vitin 1997 për UÇK-në ka qenë Latif Gashi, kështu?

8 PË. Po.

9 PY. Më pas ju jeni caktuar udhëheqësi i ri i zonës në një  
10 takim ku kanë marrë pjesë katër veta, ju, Latif Gashi, Ilir  
11 Konushevski dhe z. Ajeti, kështu?

12 PË. Ashtu ishte. Ishte marrëveshje, ndoshta vendim është  
13 vështirë me i thënë, po ishte konfirmim. Krejt u pajtuan që  
14 unë të vazhdoja punën e komandantit të zonës.

15 PY. Po ju të katër u pajtuat për këtë gjë, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Në shtator të vitit 1997, ju ratë dakord ose formuat një  
18 -- kishit një marrëveshje, nënshkruat një marrëveshje me  
19 Fatmir Humollin që ishte pjesëtar i LKÇK-së, kështu?

20 PË. Po, jemi pajtuar për bashkim të fuqisë, të forcave.

21 PY. Dhe ju u pajtuat që të krijonit njësitin BIA, që e  
22 diskutuat edhe me Prokurorinë, domethënë, atë takim të shtator  
23 të 1997, ju vendosët që të krijohej njësitin BIA, kështu?

24 PË. Në njësitin BIA s'kam pasë rol unë. Ai ka qenë veç i  
25 formuar, por unë kam pajtue që struktura e LKÇK-së të

1 shkriheshin në UÇK, të vinin në UÇK.

2 PY. Dhe njëra prej këtyre strukturave ishte njësitë BIA,  
3 kështu?

4 PË. Po. Ishin anëtarë e LKÇK-së.

5 PY. Nuk do ta shfaqim dhe një herë videon nga BBC-ja në  
6 përjashtim të rasteve në qoftë se është e nevojshme,  
7 megjithatë, ju parashtroj që ju i keni thënë BBC-së që në fund  
8 të 1997 kishte 18 anëtarë të UÇK-së në zonën tuaj. A është e  
9 saktë kjo?

10 PË. E saktë ka qenë. Çarë kam fol për BBC-në ka qenë e saktë.

11 PY. Është e saktë edhe sot e kësaj dite?

12 PË. Nuk janë shumuar në atë kohë.

13 PY. Në rregull. Dhe në të njëjtën video thatë që deri në  
14 mars, domethënë, deri në fund të marsit numri i pjesëtarëve të  
15 UÇK-së në zonën tuaj u rrit deri në 100. A ju kujtohet kjo?  
16 Tash mundet me pasë ndonjë gabim ndonjë numër plus minus por  
17 aty dikund ishte.

18 PY. Çfarë ndodhi, çfarë ngjarje ndodhi nga fundi i 1997 deri  
19 në fund të marsit që çoi në rritjen domethënëse ose të madhe  
20 të ushtarëve të UÇK-së në zonën tuaj?

21 PË. Sulmi mbi familjen e komandantit Jashari ka ndikue, i ka  
22 pasë ndikimet jashtëzakonisht të mëdhaja për ardhjen e  
23 rekrutëve të UÇK-së ku ne s'kemi mund me i ndalë.

24 PY. Deri në vdekjen e Adem Jasharit, a do ishte e drejtë të  
25 thuhet se UÇK-ja deri në atë moment ishte më tepër një

1 organizatë guerile?

2 PË. Edhe ka qenë guerile.

3 PY. Dhe që funksiononte me një strukturë shumë të  
4 decentralizuar, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Por pas vdekjes së Adem Jasharit, a është e drejtë të  
7 thuhet se ju dhe me rritjen e numrit të personave që u kyçën  
8 në UÇK, ju vendosët të krijonit atë çfarë ju e quajtet ushtri  
9 frontale?

10 PË. Po.

11 PY. A mund të na shpjegoni se pse u bë kalimi nga një  
12 organizatë e decentralizuar guerile në një ushtri frontale pas  
13 marsit të 1998?

14 PË. Kemi shfrytëzuar burimet për armatosjen nga ngjarjet në  
15 Shqipëri. Përkrahjen e madhe për familjen Jashari që në atë  
16 kohë ishte e shqiptarëve duke përkrahë familjen Jashari na  
17 përkrahnin edhe neve si Ushtri Çlirimtare të Kosovës. Dhe kemi  
18 shfrytëzuar të gjitha këto për të qenë prezent gjithkund aty ku  
19 mundnim ne si Ushtri Çlirimtare të Kosovës.

20 Ne kemi qenë të vumë nën presion të vullnetarëve dhe në  
21 mënyrë kemi pranuar dhe këtë mënyrë të pakontrolluar që edhe  
22 sot e kësaj dite nuk besoj që i njohim, që kemi arrit t'i  
23 njohim mirë ata që kanë marrë armët dhe janë rreshtu bashkë me  
24 ne. Ka qenë shumë vështirë me konsolidue dhe me i ndalue  
25 njerëzit për me ardhë në ndihmë në strukturimin rreth emblemës

1 tonë që ne po udhëheqim.

2 PY. T'ju bëj një pyetje për të sqaruar pak atë çfarë thatë në  
3 fjalinë e parë të përgjigjes, thatë që:

4 "Përdornim burime dhe linja furnizimi të krijuar asi  
5 rezultat i ngjarjeve në Shqipëri".

6 Ju lutem a na shpjegoni se për çfarë ngjarjesh në  
7 Shqipëri e keni fjalën?

8 PË. Në Shqipëri aso kohe ka pasë ndodhë një shpërthim i  
9 pakënaqësive, ka ardhë deri aty ku kanë shpërthy edhe depot e  
10 armatimit kanë qenë të pakontrollume. Kemi mujt me përfitue  
11 nga situata e brishtë në shtetin shqiptar dhe kemi organizu,  
12 jemi organizu qysh kemi mujt e qysh kemi ditë për të marrë sa  
13 armë që mundemi të sillnim me krahë nga Shqipëria në Kosovë.

14 Unë personalisht me numër të ushtarëve kam qenë në  
15 Shqipëri për t'u armatosur.

16 PY. Çfarë kuptoni kur thoni, për shembull, që u angazhuat në  
17 "një luftë frontale"? Çfarë do të thotë kjo për juve, na e  
18 shpjegoni pak ju lutem?

19 PË. Kjo do të thotë luftë totale, luftë e përgjithshme për  
20 ne, krejt çka mundnim me bë për vendin tonë. Ne ekspozoheshim  
21 para forcave armike dhe po e përçonim lajmin në gjithë botën  
22 se çfarë po ndodhë në vendin tonë. Ne edhe ashtu ishim të  
23 okupue rënd nga armiku, po donim ta bënim të qartë sa më shumë  
24 para botës se çfarë po ndodh në vendin tonë.

25 PY. UÇK-ja që po formonit ju ishte një ushtri tërësisht

1 vullnetare apo jo?

2 PË. Po, sigurisht. Edhe po të donim ne të mos organizoheshim  
3 popullata do të organizohej në një formë ose një tjetër. Po që  
4 unë besoj që kemi pasë rol të rëndësishëm për udhëzimin e  
5 njerëzve edhe për organizimin, drejtimin drejt synimeve tona  
6 që kishim për pavarësinë e Kosovës.

7 PY. Vullnetarë do të thotë që njerëzit mund të kyçeshin dhe  
8 të çkyçeshin kur të donin, kështu?

9 PË. Po. Po, sigurisht.

10 PY. Në këtë periudhë kohe, pra, po flasim pak a shumë për  
11 majin e 1998, gjashtë muaj përpara majit të 1998 ju u përpoqët  
12 që të rekrutonit Nurebin Ibishin në UÇK-në e zonës tuaj,  
13 kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe në maj, deri në maj të 1998, ju kishit caktuar si  
16 anëtar të stafit tuaj Latif Gashin, kështu?

17 PË. Anëtar të stafit, po.

18 PY. Fatmir Humollin?

19 PË. Po.

20 PY. Hyzri Tallën?

21 PË. Po.

22 PY. Sejdi Ramën?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe Avdi Kiqmarin?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe deri në maj të 1998, ju arritët që të rekrutonit edhe  
2 Nuredin Ibishin në zonën tuaj, kështu?

3 PË. Po, e kemi pasë përfunduar bisedën.

4 PY. Z. Ibishi u bë komandanti i brigadës për njësitin 151?

5 PË. 152.

6 PY. 152. Gjatë kësaj periudhe, për çështje logjistike, ju  
7 ishit personi që ishit jashtëzakonisht i aftë në fushën e  
8 logjistikë, është e saktë kjo?

9 PË. Unë po përpiqem në fushën e logjistikës të isha sa më  
10 mirë.

11 PY. Dje, besoj që ishte, kur përmendët që patët mundësi që të  
12 siguronit armë nga burime në Bosnjë dhe në Serbi, kështu?

13 PË. Po.

14 PY. Po ashtu patët mundësi patët mundësi të siguronit fonte  
15 nga diaspora, kështu?

16 PË. Fonte nga diaspora, por nga Prishtina kryesisht. Nga  
17 ndërmarrësit e Kosovës.

18 PY. Pra, a do ishte e drejtë të thuhet që sa i takon  
19 mbështetjes logjistike zona e Llapit ishte e mbështetur e  
20 siguruar prej jush, prej jush personalisht dhe ju vetë kishit  
21 marrë shumë pak mbështetje nga Shtabi i Përgjithshëm për sa i  
22 takon logjistikës, kështu?

23 PY. Unë, z. Avokat, Prishtina më ka ofrue shumë nga personeli  
24 në ushtarë, shumë nga qytetarët që ishin. Ata kanë qenë  
25 këshilltarë të mi. Zyra e Adem Demaçit me komplet këshilltarët

1 e tij më kanë ofruar këshilla dhe ndihmat. Domethënë, nuk ishte  
2 punë vetëm e imja. Ishin të gjitha subjektet politike që po më  
3 përkrahnin. Dhe unë besoj më shumë kam ofruar të mira  
4 logjistike Shtabit të Përgjithshëm sesa Shtabi i Përgjithshëm  
5 mua.

6 PY. Sa i takon rekrutimit të personave në UÇK në zonën tuaj  
7 ju kishit një rol të rëndësishëm sa i takon rekrutimit,  
8 kështu?

9 PË. Po, isha komandanti.

10 PY. Edhe z. Gashi, kishte rol të rëndësishëm për rekrutimin e  
11 personave në zonën e Llapit?

12 PË. Të gjithë ne bashkarisht po rekrutonim, po udhëzonim.

13 PY. Në këtë periudhë maj, qershor 1998, në fakt, ju po  
14 përpiqeshit që të shtonit, domethënë, po intensifikonit  
15 kontaktin me Shtabin e Përgjithshëm, kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Sepse nuk kishit pasur shumë kontakt me Shtabin e  
18 Përgjithshëm para kësaj periudhe, saktë?

19 PË. Po.

20 PY. Asnjëherë nuk keni dorëzuar ndonjë raport me shkrim  
21 Shtabi i Përgjithshëm, saktë?

22 PË. Asnjëherë.

23 PY. Asnjëherë nuk ju kërkua, as nuk ju është kërkuar  
24 ndonjëherë që të jepni ndonjë raport me shkrim Shtabit të  
25 Përgjithshëm, saktë?

1 PË. Nuk më kujtohet është kërkuar, as që s'është kërkuar. Nuk  
2 më kujtohet.

3 PY. Në 17 qershor të 1998, ju kujtohet që keni udhëtuar me 24  
4 luftëtarë të tjerë të zonës tuaj për të shkuar drejt  
5 Shqipërisë që të merrnit armë?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe për të shkuar në Shqipëri për të marrë armët, a patët  
8 shans a patët ndonjë mundësi të takoheshit me komandantin e  
9 zonës së Dukagjinit z. Haradinaj rrugës për në Shqipëri?

10 PË. Jam takuar duke shkuar ose duke ardhë. Nuk më kujtohet  
11 saktë ta them se cilën, a duke u kthyer apo duke shkuar e kam  
12 takuar.

13 PY. A ju kujtohet të jeni larguar më 17 qershor dhe jeni  
14 kthyer nga Shqipëria më 8 korrik? Është e saktë pak a shumë  
15 periudha kohore?

16 PË. Përafërsisht aty ishte.

17 PY. A kishit krijuar një marrëdhënie me z. Haradinaj gjatë  
18 kësaj kohe sepse duhet të kalonit përmes zonës së tij për të  
19 shkuar në Shqipëri?

20 PË. Po. Për herë të parë kemi krijuar raporte me z. Haradinaj  
21 dhe është tha, domethënë, është lejue që të gjithë kapaciteti  
22 i UÇK-së në zonën e Dukagjinit me kanë, me qenë në ndihmë të  
23 njerëzve me të cilët unë po kaloja. Është pajtuar.

24 PY. Kadri Kastrati erdhi në zonën tuaj për t'ju ndihmuar me  
25 transferimin e UÇK-së nga një organizatë guerile në një ushtri

1 frontale, saktë?

2 PË. Po, ishte ai grupi i oficerëve të udhëhequr nga Bislir  
3 Zyrapit. Z. Kadri Kastrati kishte ardhë te unë dhe ai na ka  
4 ndihmuar shumë.

5 PY. Është e drejtë të themi që ju personat si Kadri Kastrati  
6 dhe Bislir Zyrapit i konsideronit persona me shumë përvojë që  
7 mund t'ju ndihmonin ju në përpjekjet tuaj në zonë?

8 PË. Po, ishin shumë të mirëseardhur.

9 PY. Po ju personalisht ishit komandanti i zonës, saktë?

10 PË. Po.

11 PY. A ju kujtohet që më 18 korrik keni emëruar Hamit Halitin  
12 si shefin e logjistikës?

13 PË. Hamit Hamitin, po.

14 PY. Ju kërkohet ndjesë. Po, Hamit Hamitin.

15 PË. Ka qenë më herët i emëruar, por unë e kam bërë të njohur  
16 për stafin ma vonë, në këto kohë që po thoni ju është bërë e  
17 njohur për ushtarë tjerë.

18 PY. Po Fatmir Humolli? A ju kujtohet ta keni emëruar shefin e  
19 moralit dhe të politikës më 18 korrik të 1998?

20 PË. Datat nuk i mbaj mend, por e di që është emëruar.

21 PY. Keni emëruar z. Ibishi, Nuredin Ibishi, si komandant të  
22 cilës brigadë?

23 PË. 152.

24 PY. Ju e keni emëruar në korrik të 1998. Po Idriz Shabanin  
25 komandant i cilës brigadë u emërua?

1 PË. 151. Kush e mori vendimin për t'i emëruar këta persona?

2 PË. Unë me stafin, me njerëzit që deri në atë kohë njiheshin  
3 mes veti, ushtarët më të vjetër që ishin.

4 PY. Kujt i raporttonin?

5 PË. Po mendon këta që unë po i emëroja?

6 PY. Po.

7 PY. Mua.

8 PY. Të pyesim pak për vizitën e delegacionit të Shtabit të  
9 Përgjithshëm në gusht të 1998. Ju theksuat se ishit emëruar  
10 "formalisht" si komandant i zonës së Llapit nga ky delegacion  
11 në gusht të 1998. Dhe kur ju pyeti Prokuroria, ju thatë se  
12 shumë kohë më përpara, në fakt, ju kishit qenë komandant i  
13 zonës së Llapit. Pse ishte e nevojshme që të merrnit emërim  
14 formal nga Shtabi i Përgjithshëm? Cili ishte qëllimi?

15 PË. Koha kur po përpiqeshim të bëheshim sa më të rregullt që  
16 të komunikonim mes veti. Të bënim, të përpiqeshim të krijonin  
17 rend, rregull. Të organizoheshim më mirë.

18 PY. E kuptoj siç duhet që ka qenë thjesht një përpjekje për  
19 t'u përpjekur të dukeshit si një ushtri.

20 PË. Po.

21 PY. Është e saktë të themi, kështu?

22 PË. E saktë qe.

23 PY. Por, në realitet ju kishit qenë komandant goxha kohë më  
24 përpara se të merrnit emërimin formal të gushtit 1998, saktë?

25 PË. Po.

1 PY. Dhe personat në stafin tuaj ishin emëruar prej jush  
2 përpara se të merrnit ju emërimin formal në gusht të 1998,  
3 kështu?

4 PË. Po.

5 PY. Pjesë e delegacionit të Shtabit të Përgjithshëm që erdhi  
6 në zonën tuaj, ishin z. Thaçi dhe z. Rexhep Selimi. Ju pyeti  
7 Prokuroria në intervistën që patët lidhur me ta dhe ju u  
8 përgjigjët se pse ata thjesht po kalonin dhe "kishin  
9 destinacionin e tyre tjetër". Ju kujtohet ku po shkonin?

10 PË. Unë ende s'i kam pyet me saktësi se do të më tregonin,  
11 por mendoj që te Adem Demaçi kanë mund të takohen.

12 PY. Adem Demaçi ishte në Prishtinë?

13 PË. Po.

14 PY. Adem Demaçi ishte emëruar kohët e fundit?

15 PË. Adem Demaçi ka qenë i njohur për të gjithë neve edhe për  
16 anëtarët e shtabit të tjerë dhe për mua dhe kemi pasë kontakte  
17 gjithë më herët. Meqë s'ka qenë e rëndësishme ka qenë i  
18 emëruar apo jo kontaktet me të ishin.

19 PY. E kuptoj këtë. Po dua të them, thjesht, kohët e fundit,  
20 mbase ditë apo javë më përpara ishte emëruar si përfaqësuesi  
21 politik i UÇK-së, domethënë, pak ditë apo pak javë para  
22 gushtit të 1998, saktë?

23 PË. Besoj që po. Po unë më lejoni t'ju them se unë edhe më  
24 herët kam fol për UÇK-në me Adem Demaçin. Personalisht me Adem  
25 Demaçin kam fol për UÇK-në edhe gjatë vitit 1996 dhe 1997.

1 PY. Dëshmitar, tani kam disa pyetje për luftën speciale.  
2 Rreth kësaj periudhe kohore, pra, gusht 1998 a kishte ndonjë,  
3 a perceptohej se kishte ndonjë farë problemi me  
4 bashkëpunëtorët, a mendohej se kishte ndonjë problem me  
5 bashkëpunëtorët?

6 PË. Me bashkëpunëtorët gjithherë ka pasë probleme. Por  
7 specifikisht s'po më kujtohet diçka.

8 PY. Ju kujtohet se i thatë ZPS-së sa i takon çështjes së  
9 ndalimeve, "të gjitha veprimet ishin të nevojshme për  
10 vetëmbrojtje"? Pastaj vazhdoni:

11 "Të gjitha veprimet ton a janë marrë apo janë kryer vetëm  
12 në kuadër të vetëmbrojtjes prandaj mendoj se me të drejtë kemi  
13 mbajtur të ndaluar një numër të vogël shqiptarësh sepse  
14 veprimet e tyre dhe bashkëpunimi me forcat armike po vinin në  
15 rrezik ushtrinë tonë dhe civilët që ne po mbronim".

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky është materiali SPOE00119323  
17 deri në 00119333 dhe SPOE00119329 deri në 330.

18 PY. A ju kujtohet të keni thënë në gjykimin tuaj që kushdo që  
19 është mbajtur i ndaluar është mbajtur në interes të  
20 vetëmbrojtjes, në kuadër të vetëmbrojtjes?

21 PË. Po.

22 PY. Çfarë keni dashur të thoni me këto fjalë?

23 PË. Kam dashur të them se për arsye ushtarake janë ndaluar  
24 ata që kemi ndaluar.

25 PY. Personat janë mbajtur të ndaluar për shkak të faktit se

1 ish in anëtarë të LDK-së?

2 PË. Jo. Jo, zotëri.

3 PY. A keni ndonjë mendim tuaj in lidhur me teorinë që LDK-ja  
4 mbante të ndaluar persona sepse ish in kundërshtarë politik?

5 PË. LDK-ja ka qenë në përkrahje të luftës për çlirimin e  
6 Kosovës në regjionin tim.

7 PY. Kërkoj falje. Thashë LDK-ja mbante të ndaluar persona,  
8 doja të thoja UÇK-ja ndalonte persona.

9 PË. Nuk ka ndaluar UÇK-ja persona të LDK-së.

10 PY. Ka qenë i pranishëm FARK-u në zonën tuaj?

11 PË. Jo.

12 PY. Është mbajtur njeri i ndaluar se ishte anëtar i FARK-ut  
13 në zonën tuaj?

14 PË. Jo.

15 PY. A keni krijuar gjykata në zonën tuaj?

16 PË. Jo.

17 PY. A keni emëruar gjykatës në zonën tuaj?

18 PË. Jo.

19 PY. A keni emëruar prokurorë në zonën tuaj?

20 PË. Jo.

21 PY. Pse jo?

22 PË. Pse se s' kemi pasë kohë. Nuk kemi arrit kurrë deri aty.

23 PY. Në rregull. Po ka pasur arsye përse nuk mbërritët deri  
24 këtu?

25 PË. Ka qenë kohë e shkurtë, kohë e shpejtë e zhvillimeve. Nuk

1 kemi pasë resurse. Ne s'kemi arrit deri të organizoheshim edhe  
2 pse kemi dashtë.

3 PY. Prokuroria pretendon se rreth datës nga 2 gushti deri në  
4 mes të shtatorit janë mbajtur të ndaluar disa persona nga  
5 anëtarë të UÇK-së në zonën e Llapit. A jeni në dijeni për  
6 këtë?

7 PË. Po.

8 PY. A keni ndonjë shpjegim përse janë mbajtur të ndaluar këta  
9 persona?

10 PË. Thjesht për arsye ushtarake, ju thashë më herët. Ose kanë  
11 ra drejtpërdrejt në kundërshtim me rregullat tona, me misionin  
12 tonë.

13 PY. Dua t'ju pyes për një komunikatë që jua treguan dy herë.  
14 Është Komunikata 54. Prokurorja ta tregoi dy herë komunikatën  
15 gjatë kohës që po ju bënte pyetje.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe unë do të doja që të shfaqej  
17 në ekran. Është P00156, shqipja P00156 po ashtu me -AT.

18 PY. Ju kanë pyetur, t'u lexua më saktë fjalinë te teksti me  
19 shkronja të errëta:

20 "Të gjithë emisarët e armikut dhe përhapësit e luftës  
21 speciale kushdo qofshin ata të trajtohen sipas ligjeve në  
22 rrethana lufte...".

23 Data e komunikatës është 22 shtator 1998. Në fund të  
24 faqes tek shqipja e shihni?

25 Z. Mustafa, unë ju them se dy të ndaluarit e fundit që

1 janë mbajtur të ndaluar në fillim të gushtit, dy të fundit -  
2 mund t'i them emrat në seancë private nëse dëshiron Trupi  
3 Gjykues - u liruan nga zona juaj katër ditë pasi u publikua  
4 kjo komunikatë, më 26 shtator 1998. Dhe se nuk ka asnjë  
5 pretendim nga Prokuroria për këtë rast, nuk mund të thotë që  
6 ka pasë të ndaluar në zonën tuaj nga mesi i shtatorit deri në  
7 nëntor. E kuptoni këtë që thashë?

8 PË. Po.

9 PY. Pra, a pajtoheni me mua se nuk ka asnjë lidhje mes kësaj  
10 komunikate dhe ndonjë ndalimi në zonën tuaj?

11 PË. Pajtoj. Kjo komunikatë nuk ka mujt me komentue.

12 PY. Dhe vij në pyetjet themelore. Ju jeni avokat, jurist më  
13 saktë?

14 PË. Kam përfundue fakultetin e drejtësisë.

15 PY. Çfarë viti e keni përfunduar fakultetin e drejtësisë?

16 PË. Në 1996 përfundova studimet. Provimin e fundit -- dy  
17 provimet e fundit i kam japur në vitin 2000. Si absolvend kam  
18 shku në luftë.

19 PY. Gjatë kohës që studionit e keni studiuar mbase dhe Kodin  
20 Penal të Jugosllavisë të vitit 1976?

21 PË. Po.

22 PY. Komunikata që kemi në ekran thotë:

23 "Se të gjithë emisarët dhe përhapësit e luftës speciale  
24 kushdo qofshin ata do të trajtohen sipas ligjeve në rrethana  
25 lufte..."

1 E dinit ju si i trajtonte e drejta jugosllave çështjet e  
2 spiunazhit, për shembull, si e trajtonte spiunazhin?

3 PË. Nuk kam pasë, s'kam pasë njohuri të përgjithshme por kanë  
4 qenë shumë eprorë të ish-Jugosllavisë që e kanë njof këtë punë  
5 dhe kam qenë i këshilluar nga ata.

6 PY. A e dinit ju se neni 128 dhe 139(2), dikush mund të  
7 dënohej me vdekje në Jugosllavi për bashkëpunim në kohë lufte?

8 PË. E di këtë. Kështu.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar i Trupit Gjykes kam  
10 një temë tjetër. Kështu që mund të jetë koha e përshtatshme  
11 për të bërë pushimin por gjithashtu dua të trajtoj diçka me  
12 Trupin Gjykes sa i takon organizimit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
14 shoqëroni dëshmitarin jashtë sallës së gjyqit.

15 Dëshmitar, do të bëjmë gjysëm ore pushim.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, unë kisha thënë  
18 që më nevojiten tetë-shtatë orë bazuar në një material prej 30  
19 faqesh po unë po punoj shumë shpejt dhe mendoj se do mbaroj në  
20 seancën e radhës sepse i përfundova pjesën më të madhe të  
21 pyetjeve.

22 Po ta them tani sepse mund të na duhet dëshmitari rezervë  
23 duke pasur parasysh këtë ndryshim. Ju kërkoj ndjesë unë  
24 mendova se do të zgjatje shumë më shumë por në fakt eci më  
25 shpejt nga ç'kisha parashikuar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta  
2 diskutojmë gjatë pushimit dhe do të flasim kur të kthehemi.  
3 Prokurore.

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua të them diçka. Nëse na duhet  
5 dëshmitari rezervë, sikurse u tha me email, që besoj se është  
6 Dëshmitari 4586, ne duhet të bëjmë një kërkesë për dëshmi me  
7 videolidhje për shkak të problemeve shëndetësore të cilën ne e  
8 kemi bërë me dije në fillim të kësaj jave.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, do na  
10 jepni një përditësim.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Duke pasur parasysh faktin që z.  
12 Misetic i rishikoi vlerësimin kohor dhe e ndryshoi, unë isha  
13 kisha parashikuar që ta bëja të hënën pjesën time të pyetjeve.

14 Por mund t'ju kërkoj ju lutem, që në qoftë se ti Misetic  
15 mbaron më herët për seancën tjetër ta bëjmë pushimin deri në  
16 orën 2.00 dhe që të organizohemi dhe ne mes njeri-tjetrit në  
17 mënyrë që të bëjmë pyetjet tona?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shkëlqyeshëm.  
19 Mund ta bëjmë këtë thjesht më kujtoni në qoftë se harroj.

20 Bëjmë pushim deri në orën 11.30.

21 --- Pauza fillon në orën 10.57

22 --- Seanca rifillon në orën 11.32

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.  
24 Prokurore, ne po mendonim që ndoshta është mirë që ju të  
25 përgatiteshit për dëshmitarin e radhës. Pra, besoj që ajo

1 duhet të jetë në disponueshmëri dhe në qoftë se do të na duhet  
2 që ta anulojmë, mund ta anulojmë, megjithatë mendoj se është e  
3 rëndësishme që juve të përgatiteni që dëshmitarja të jetë e  
4 gatshme për të dhënë dëshmi përmes videolidhjes.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jemi të gatshëm që të bëjmë  
6 kërkesën për pranimin e dëshmisë së dëshmitares përmes  
7 videolidhjes, e do ta bëjmë këtë gjë menjëherë.

8 Megjithatë, po shohim të gjitha organizimet logjistike në  
9 qoftë se dëshmitari përfundon më përpara. Megjithatë, në qoftë  
10 se nuk do të bëhet, nuk do të jetë e mundur që të thërrasim  
11 dëshmitarin 4586 mbase mund të japim mundësinë që të thërrasim  
12 një tjetër dëshmitar. Domethënë do të shikojmë sesa kohë do të  
13 na mbetet në mënyrë të tillë që të trajtojmë dëshmitarin  
14 brenda kohës së mbetur. Domethënë mund të shikojmë gjithashtu  
15 dhe dëshmitarin 0772 që mund të jetë mundësi për të thërritur  
16 për të dhënë dëshmi. Do të bëjmë kontrollet e nevojshme edhe  
17 kur të kemi informacionin e nevojshëm për mënyrën sesi do të  
18 procedojmë më tej atëherë do të komunikojmë informacionin për  
19 palët edhe për Trupin Gjykses.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, është e  
21 rëndësishme që linja e komunikimit të jetë e hapur.  
22 Faleminderit.

23 Znj. Sekretare, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin në  
24 sallë.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Një çështje për të ngritur përpara

1 sesa të vijë dëshmitari. Dua që të paraqes pjesën e z.  
2 Haradinaj që u lexua në sallën e gjyqit si provë materiale për  
3 regjistrim në provë materiale. Më konkretisht bëhet fjalë për  
4 dokument U017-5901 deri në U017-6091 dhe dokumentacionin  
5 përkatës shoqërues në shqip në KSC-BC-2020-IT-05-87.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka  
8 kundërshtim. Libri i z. Haradinaj, dhe nuk do t'i përsëris  
9 numrin e dokumenteve, pra, pranohet në prova materiale.

10 Znj. Sekretare ju lutem caktojini një numër.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Për të konfirmuar, po  
12 flalsim që do të pranohet vetëm faqja që u lexua apo i gjithë  
13 libri.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm ajo  
15 faqe.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo faqe do të marrë  
17 numrin e provës materiale 1D25.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

20 Do të vazhdojmë me kundërpyetjen e dëshmitarit nga Mbrojtja e  
21 z. Thaci.

22 Z. Misetic, vazhdoni.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

24 Znj. Sekretare kërkoj që të shfaqet në ekran DHT00509  
25 deri në faqen pasardhëse.

1 PY. Z. Mustafa, ju kërkoj ndjesë për -- është një artikull  
2 gazete që është vetëm në gjuhën angleze. Megjithatë, ky është  
3 një dokument i cili u përmend nga Prokuroria edhe që ju bë  
4 pyetje lidhur me këtë. thjeshtë dua që t'i vë një datë  
5 Marrëveshjes Miloshevic-Holbrook. A është e saktë të thuhet që  
6 kjo marrëveshje ka ndodhur rreth datës 9 tetor 1998?

7 PË. Po besoj që po.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj që ky  
9 dokument të pranohet në prova materiale.

10 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim, i nderuar  
11 Gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
13 DHT00509 deri në DHT00510 pranohet në prova materiale.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, të  
15 nderuar Gjykatës, dokumenti nga DHT00509 deri në DHT00510 do  
16 të pranohet në prova materiale me numrin 1D26.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani kërkoj që të paraqitet në  
18 ekran një dokument që ka të bëjë me krijimin e Misionit të  
19 Verifikimit në Kosovë. Është dokument IT-05-87.1 P00835.  
20 Versioni në shqip është IT-05-97.1 deri në P00835.

21 PY. Z. Mustafa, kjo marrëveshje midis Jugosllavisë dhe OSBE-  
22 së e nënshkruar nga z. Zivadin Jovanovic, Ministri i Punëve të  
23 Jashtme të Jugosllavisë dhe kryetarit të OSBE-së, Bronislaw  
24 Geremek. Në faqen e fundit thuhet që është nënshkruar me 16  
25 tetor 1998, disa ditë pas marrëveshjes ndërmjet Milosheviçit

1 dhe Holbrook. Nëse do të shohim faqen katër të provës  
2 materiale, në pikën 3.8, që ka të bëjë me drejtat dhe  
3 detyrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë. Thuhet që:

4 "Drejtori i Misionit do të marrë përditësime periodike  
5 nga autoritetet përkatëse lidhur me akuzat eventuale për  
6 veprime abuzive nga ana e personelit ushtarak, apo policor dhe  
7 për statusin e veprimeve disiplinore apo ligjore të marra ndaj  
8 individëve të implikuar në abuzime të tilla."

9 Numri 9 thotë që:

10 "Misioni i Verifikimit do të mbajë lidhje me autoritetet  
11 e FRJ-së apo serbe dhe sipas raste ato kosovare dhe KNKK-së  
12 lidhur me mundësitë për kontakte me personat e ndaluar.

13 A i shikoni këto dy pika z. Mustafa?

14 PË. Po.

15 PY. A jeni vënë në dijeni në tetor të vitit 1998 që Misioni i  
16 Verifikimit të OSBE-së -- ta them ndryshe që në fakt KNKK-ja  
17 do të kishte të drejtë të kishte qasje tek personat e mbajtur  
18 apo të ndaluar në pajtim me këtë marrëveshje?

19 PË. Në atë kohë nuk po më kujtohet që e kam njoft këtë  
20 marrëveshja këtë pikë që sapo lexuam po unë e di se me  
21 anëtarët e misionit verifikues kemi folur për çështje lidhur  
22 me të ndaluar dhe i kemi lejuar kontaktet me ta.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Kryegjykatës, kërkoj që ky  
24 dokument të pranohet në provë materiale.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk mendojmë

1 që ka bazë për pranimin e këtij dokumenti mbështetur mbi atë  
2 që tha dëshmitari, megjithatë nuk e kundërshtojmë dokumentin  
3 në vetvete.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti IT-  
5 05-87.1 deri në P00835 pranohet në provë materiale.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ky  
7 dokument merr numrin e provës materiale 1D27.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Ju lutem më lejoni  
9 një çast.

10 Dua të paraqitet në ekran dokumenti SPOE00055799 deri në  
11 SPO00055868-ET i Rishikuar në faqen SPOE00055837; dhe versioni  
12 në gjuhën shqipe është SPOE00055678 deri në SPOE00056018 në  
13 faqen SPOE00055837.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
15 kemi dy dokumente që përfundojmë me ET e Rishikuar dhe ET e  
16 Rishikuar 1. Cili nga versionet duhet të paraqitet?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Versioni që përfundon me ET e  
18 Rishikuar 1.

19 PY. Ky është një fragment nga libri i z. Skënder Zhitia.  
20 Prokuroria ju bëri disa pyetje lidhur me këtë libër. Dhe  
21 dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje të tjera duke u mbështetur në  
22 atë që thatë më herët që nuk e mbani mend kohën e arritjes së  
23 marrëveshjes ndërmjet OSBE-së dhe Jugosllavisë.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në fund të faqes në  
25 versionin anglisht. Të njëjtën gjë edhe në versionin shqip. Ju

1 lutem.

2 PY. Këtu në libër thuhet që: Pas marrëveshjes të arritur  
3 ndërmjet Serbisë -- bashkësisë ndërkombëtare dhe Serbisë e  
4 njohur ndryshe si Hollbrook-Milosevic, NZOLL-i ishte vizituar  
5 nga shefi i KDOM-it i shoqëruar nga Adem Demaçi dhe Arben  
6 [sipas përkthimit] Kurti. Në këtë takim komandant Remi ishte i  
7 shoqëruar nga..." - dhe kalojmë në faqen tjetër - "...Nuredin  
8 Ibishi, Latif Gashi, Fatmir Humolli e ushtarë të tjerë të  
9 shtabit të NZOLL-it. Takimi kishte karakter njoftues rreth  
10 marrëveshjes së arritur si dhe obligimeve që dilnin nga kjo  
11 marrëveshje.

12 Ndalojmë këtu për një çast. A ju kujtohet ky takim ku  
13 Shaun Byrnes iu vizitoi pas marrëveshjes midis Miloseviçit dhe  
14 Hollbrook i shoqëruar me Arben [sipas përkthimit] Demaçin dhe  
15 Albert [sipas përkthimit] Kurtin.

16 PË. Po, më kujtohet.

17 PY. A ju kujtohet tani që ka pasur një diskutim sa i takon  
18 detyrimeve që do të dilnin nga kjo marrëveshje?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe njëri prej detyrimeve të parashikuara në marrëveshje  
21 ishte që t'i jepej qasje KNKK-së tek personat e ndaluar?

22 PË. Me siguri se është shpjeguar në tërësi marrëveshja.

23 PY. Viojmë me fjalinë tjetër në libër.

24 "Në takim gjithashtu u bisedua edhe rreth organizimit të  
25 strukturave të policisë së ardhme të Kosovës në fazën e parë

1 pas çlirimit.”

2 A e shihni këtë fjali?

3 PË. Po.

4 PY. A ju kujtohet se në tetor ose rreth tetorit 1998 Shaun  
5 Byrnes ka bërë një bisedë me juve lidhur me organizimin e  
6 strukturave të policisë së ardhme të Kosovës?

7 PË. Po, më kujtohet.

8 PY. A ju kujtohet ndonjë gjë posaçërisht? Ndonjë gjë e  
9 veçantë që është trajtuar në atë bisedë?

10 PË. E di që është shprehur i kënaqur me z. Nuredin Ibishi,  
11 pas njohjes me profesionalizimin e tij, siç tha ai në atë  
12 kohë. E di se kemi lënë kontakte të vazhdueshme me KDOM-in dhe  
13 OSBE-në.

14 PY. Pyetja ime është kjo: Sa i takon çështjes konkrete të  
15 organizimit të strukturave të policisë në të ardhmen domethënë  
16 pas çlirimit të Kosovës, a të kujtohet të kesh biseduar ndonjë  
17 gjë konkrete lidhur me këtë temë me z. Byrnes?

18 PË. Jo, nuk më kujtohet e di se kemi folur për policinë  
19 ushtarake me të, se duhet të profesionalizohet dhe ai ka  
20 menduar se do të jetë policia e ardhshme e Kosovës. Ka  
21 sugjeruar.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës kërkoj që ky  
23 fragment i librit të Zhitisë të pranohet në provë materiale.  
24 Besoj që edhe Prokuroria ka kërkuar që fragmente të caktuara  
25 të këtij libri të pranohen si provë materiale dhe nuk e di në

1 qoftë se do të preferoj ose do të ishte më mirë që të kemi të  
2 parashtrojmë faqet e veçanta të këtij libri që dëshirojmë të  
3 pranohen në prova materiale dhe këtë pastaj t'ja bëjmë me dije  
4 të gjitha palëve.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të  
6 vazhdoni me këtë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Z. Mustafa, në të njëjtën linjë pyetjesh dëshiroj që t'ju  
9 tregoj një fragment tjetër videoje të BBC-së të intervistës që  
10 keni organizuar me BBC-në që është e shkurtër, në fakt është  
11 vetëm një minutë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal është dokumenti  
13 DHT01152 deri në transkriptin shoqërues që jepet në dokumentin  
14 DHT01152-TR.

15 PY. Është e njëjta procedurë. Z. Mustafa ju kërkoj të dëgjoni  
16 me vëmendje atë çfarë është thënë në klip pastaj do t'ju bëj  
17 pyetjen nëse gjithçka që keni thënë në atë klip në atë  
18 intervistë për BBC-në është e saktë dhe është e vërtetë me aq  
19 sa dini dhe me aq sa mbani mend.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, video duhet të fillojë  
21 në sekondën 43.

22 [Luhet videoklipi]

23 DËSHMITARI: [në videoklip] Këshillat e KDOM-it kanë qenë  
24 kryesisht që të mos merremi me civilë, mos të merremi me të  
25 burgosun, të mos i shkelim të drejtat e luftës. Ka pasë ndihmë

1 në harta. Disa harta i kemi siguruar prej tyne edhe format ma  
2 të përsosuna të luftës që janë, siç është për mos me hy nëpër  
3 qytete për shembull, sepse ende armiku është më i fortë sesa  
4 ne. Edhe ne me konë konform rregullave ndërkombëtare, sidomos  
5 me i dëgju ndërkombëtarët sa më shumë sepse ata janë që neve  
6 na ndihmojmë edhe kështu.”

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk e di në goftë se mund të  
8 fillojmë edhe një herë tjetër, të fillojmë nga sekonda 43; 35  
9 më falni.

10 [Luhet videoklipi]

11 DËSHMITARI: [në videoklip] Këshillat e KDOM-it kanë qenë  
12 kryesisht që të mos merremi me civilë, mos të merremi me të  
13 burgosun, të mos i shkelim të drejtat e luftës. Ka pasë ndihmë  
14 në harta. Disa harta i kemi siguruar prej tyne edhe format ma  
15 të përsosuna të luftës që janë, siç është për mos me hy nëpër  
16 qytete për shembull, sepse ende armiku është më i fortë sesa  
17 ne. Edhe ne me konë konform rregullave ndërkombëtare, sidomos  
18 me i dëgju ndërkombëtarët sa më shumë sepse ata janë që neve  
19 na ndihmojmë edhe kështu.”

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Z. Mustafa, ajo që keni thënë në këtë intervistë a është  
22 e vërtetë dhe e saktë me aq sa dini ju?

23 PË. Po.

24 PY. Pra, ju kujtohet takimi me KDOM-in kur keni diskutuar  
25 ndërmjet të tjerash edhe trajtimin e duhur të civilë dhe

1 respektimin e ligjeve të luftës, kështu?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe kjo do të ketë ndodhur diku rreth tetorit 1998,  
4 kështu?

5 PË. Në secilën kohë që jemi takuar me ta ata kanë këshillue  
6 për sjellje dhe mbarëvajtjen e punës. Me siguri [e  
7 pakuptueshme].

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Dëshiroj të kërkoj të  
9 regjistrohet në prova materiale ky fragment i videos edhe i  
10 transkriptit shoqërues përkatës.

11 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
13 DHT01152 dhe transkripti i DHT01152-TR pranohen në prova  
14 materiale.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
16 marrin numrin e provës materiale 1D29 [sipas përkthimit].

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Z. Mustafa, ja u bëra këto pyetje sepse unë parashtroj se  
19 me mbërritjen e KDOM-it, Shtabi i Përgjithshëm ishte shumë i  
20 zellshëm apo i gatshëm që të siguronte që UÇK-ja të  
21 perceptohej mirë në arenën ndërkombëtare, kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Kështu që ata jepnin udhëzime për mënyrën sesi të  
24 respektohej ligji i luftës sepse KDOM-i ishte i pranishëm në  
25 Kosovë dhe dëshironin që të dërgonin një mesazh të mirë ose

1 një imazh të mirë të UÇK-së në botë. E saktë kjo?

2 PË. Po.

3 PY. Juve ju bënë shumë pyetje --

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] A mund ta sqaroni pak se kush  
5 janë "ata", domethënë, "Ata janë kanë marrë ose janë dhënë  
6 udhëzime"?

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Komandantët e zonës. Për shembull a ju kujtohet që keni  
9 marrë dokumente si urdhra nga z. Zyrapi për trajtimin e  
10 civilëve të cilët i janë dërguar komandantëve të zonës?

11 PË. Po, kemi marrë rekomandime në atë kohë.

12 PY. Do i shohim bashkërisht këto dokumente pas një momenti.  
13 Megjithatë, më lejoni të vazhdoj më tej aty ku e lashë. Keni  
14 marrë, janë bërë shumë pyetje sa i takon komandantëve të  
15 zonës, ku z. Zyrapi ka qenë drejtues i këtyre takimeve ose  
16 mbledhjeve si shefi i shtabit. A ju kujtohet?

17 PË. Po.

18 PY. Më herët ju pyeta, por do e përsëris edhe një herë, z.  
19 Zyrapi nuk u bë shef shtabi deri në nëntor të 1998? Kështu?  
20 Nuk paj --

21 PË. Besoj ashtu duhet të jetë.

22 PY. Ju bënë pyetje disa herë nga intervista e ZPS-së se cilët  
23 komandantë zonash kanë qenë të pranishëm në këto mbledhje. Në  
24 përgjigje ju thatë se Rrahman Rama.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe për palët kjo përmendet në

- 1 procesverbal në faqen 506 [sipas përkthimit].
- 2 PY. Rrahman Rama pra, Rrahman Rama ishte një ndër personat që
- 3 ka marrë pjesë në këto mbledhje, e saktë?
- 4 PË. Po.
- 5 PY. Ahmet Isufi?
- 6 PË. Po, komandantët e zonave.
- 7 PY. Sylejman Selimi?
- 8 PË. Po.
- 9 PY. Shukri Buja?
- 10 PË. Po.
- 11 PY. Ramush Haradinaj?
- 12 PË. Po.
- 13 PY. Komandant Drini?
- 14 PË. Po.
- 15 PY. Në qoftë se Komandant Drini ka qenë i pranishëm në këtë
- 16 mbledhje, a jeni në dijeni të faktit që komandant Drini nuk
- 17 është bërë komandant deri me 16 dhjetor 1998 në Pashtrik?
- 18 PË. Nuk më kujtohet data, që e di që vonë është bërë, është
- 19 bërë më vonë komandant.
- 20 PY. Në rregull. Në qoftë se komandant Drini ka qenë i
- 21 pranishëm në mbledhje për të cilat po flasim, kjo nuk mund të
- 22 ketë ndodhur deri me 16 dhjetor 1998, në qoftë se data që po
- 23 ju jap unë është e saktë.
- 24 PË. Sigurisht.
- 25 PY. A ju kujtohet data kur u krijua shtabi është në

1 Llapashticë.

2 PË. Jo nuk më kujtohet data e saktë.

3 PY. A mund të ketë ndodhur në nëntor, a mund të jetë krijuar  
4 në nëntor 1998?

5 PË. Me sig -- unë ashtu e kam thënë edhe para Prokurores,  
6 fundi i tetorit, nëntori. Por nuk jam i sigurt as sot. Ka  
7 evidenca sido që të jetë.

8 PY. Do ta heq këtë pyetje që kam përpara.

9 Në mbledhjet me z. Zyrapin që ka qenë drejtues edhe me  
10 komandant Drinin kur janë diskutuar ndalimet, a pajtoheni me  
11 mua që z. Zyrapin ka theksuar rëndësinë për mbrojtjen, për  
12 sigurimin e mbrojtjes së civilëve?

13 PË. Kemi folur -- nuk më kujtohet që kemi folur për të  
14 ndaluar. Unë vetëm nga konteksti kam pranuar se ka mund me u  
15 fol. Unë ju thashë edhe dje, kjo temë është e ekzagjeruar dhe  
16 nga përfoljet e shumta -- po s'kam pse t'i iki temës që është  
17 folur ndonjëherë, por mua s'më kujtohet.

18 PY. Unë thjeshtë po përpiqem të nxjerr faktet se çfarë mund  
19 të jetë diskutuar në mbledhje të tilla.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që të shfaqet në ekran  
21 prova materiale SPOE00119161-ET dhe SPOE00119161 në versionin  
22 në shqip.

23 PY. Thuhet që data është 28 nëntor 1998. Pra, pretendohet të  
24 jetë kjo zonë dhe është një urdhëresë që pretendohet t'i jetë  
25 dërguar zonës së Llapit, dhe është nënshkruar - thuhet këtu të

1 paktën - nga z. Zyrapi. Tek pika 3 e kësaj urdhërese thuhet:

2 "Për të parandaluar sjelljet jokorrekte ndaj popullatës  
3 civile në të gjitha njësitet e UÇK-së"

4 Dhe në pikën 4 thuhet se:

5 "Ndalohet arrestimi, paraburgimi ose burgosja e personave  
6 pa urdhër të komandantit të brigadës e më lart vetëm në rastet  
7 kritike të situata luftarake apo kur kryhen vepra penale të  
8 ndryshme, si ndaj pjesëtarëve të UÇK-së, ndaj individëve dhe  
9 pushtetit civil."

10 E shikon këtë?

11 PË. Po.

12 PY. A ju kujtohet ta keni marrë këtë dokument?

13 PY. Tashi i fiksum për këtë dokument nuk më kujtohet, por unë  
14 e di që kemi marrë rekomandime dhe dokumente nga Shtabi i  
15 Përgjithshëm.

16 PY. E keni zbatuar këtë rekomandim duke urdhëruar  
17 mosarrestimin, ndalimin apo burgimin e personave pa urdhër nga  
18 komandanti i brigadës apo më lartë?

19 PË. Kjo ka qenë praktikë edhe më herët p urdhër të  
20 komandantit të brigadë s'ka mund të arrestohet askush. Por  
21 jemi përpjekur të gjitha rekomandimet ne jemi për pjekë t'i  
22 zbatojmë.

23 PY. E keni zbatuar urdhrin ku thuhet të parandalohen sjelljet  
24 jokorrekte nga të gjitha njësitet e UÇK-së?

25 PË. Nuk kanë qenë dukuri këto raste, kanë mujt me kanë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë e hapur)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 62

1 sporadike, gati të parëndësishme. Sjelljet e ushtarëve të UÇK-  
2 së kanë qenë të mira me popullsinë civile. S'ka qenë problem  
3 kjo çështje.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kërkoj të paraqes  
5 këtë dokument për provë.

6 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] S'kemi kundërshtime.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00119161  
8 pranohet.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Merr numrin e provës  
10 materiale 1D29.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të kërkoja që të shfaqej një  
12 dokument tjetër. SPOE00225260-ET dhe origjinali është  
13 SPOE0022526 [sipas përkthimit].

14 PY. Kjo është një urdhëresë e 16 dhjetorit 1998. Dhe unë po  
15 ju them se këtu komandant -- unë po ju them se komandant Drini  
16 - më falni - u emërua si komandant i zonës operative të  
17 Pashtrikut pak a shumë në këtë datë. Është nënshkruar nga  
18 Bislim Zyrapi dhe është një urdhëresë për të gjithë  
19 komandantët e zonave operative.

20 Fillimisht hidhini një sy dokumentit dhe pastaj më thoni  
21 nëse e keni parë ndonjëherë këtë dokument.

22 PË. Është dokument i përafërt me ato që na kanë ardhë, mirëpo  
23 unë tash nuk mujna me thënë se po më kujtohen me saktësi tani.  
24 Por s'kam arsye të them që nuk është dokument zyrtar i UÇK-së.

25 PY. Thuhet që:

1 "Komandantët e zonave operative duhet të forcojnë  
2 kontrollin e tyre, të angazhohen me anëtarët e komandës,  
3 komandantët e policisë ushtarake që të bëhet menjëherë  
4 ndërprerja e dukurive negative të keqpërdorimit ndaj personave  
5 dhe pasurisë private."

6 Është pika 1.

7 Paragrafi -- pika 3 thotë:

8 "Të gjitha njësitë e UÇK-së të parandalojnë sjelljet  
9 jokorrekte ndaj popullatës civile."

10 Paragrafi 4 lexon:

11 "Ndalohet arrestimi, paraburgimi ose burgosja e personave  
12 pa urdhër të komandantës të brigadës e më lartë, vetëm në  
13 raste kritike të situatave luftarake apo kur kryhen vepra  
14 penale të ndryshme, si ndaj pjesëtarëve të UÇK-së ndaj  
15 individëve dhe pushtetit civil."

16 [Pika] 6:

17 "Ndaj kryesve të veprave penale apo shkelësve të  
18 disiplinës ushtarake ndërmerren masa të menjëhershme izolimi  
19 çarmatimi dhe përcjellja në organet e gjyqit ushtarak të UÇK-  
20 së.

21 "7. Komandantët e njësive të UÇK-së janë përgjegjës për  
22 zbatimin e kësaj urdhërese."

23 E shihni?

24 "Për kryerjen e kësaj urdhërese - më falni."

25 PË. Po e shoh.

1 PY. Po s'ju kujtohet konkretisht ta keni marrë këtë dokument?

2 PË. Kam marrë kësij rekomandimesh në atë kohë. Unë e thashë  
3 edhe dje. Por me e identifiku, me e saktësu këtë dokument nuk  
4 po e du me saktësu, edhe pse s'kam arsye pse jo.

5 PY. Unë po ua tregoj këto dokumente nga z. Zyrapit sepse ju  
6 kam bërë shumë pyetje lidhur me mbledhjet që kanë pasur  
7 komandantët e zonave në takimet që kryesonte z. Zyrapit dhe unë  
8 sugjeroj, dhe po ju them, që ajo që kishte merak z. Zyrapit aso  
9 kohe, ishte të trajtoheshin siç duhet civilët dhe të  
10 kufizoheshin sa më shumë arrestimet dhe ndalimet dhe të mos  
11 bëheshin pa miratimin e komandantëve të zonave dhe kur të  
12 bëheshin të bëheshin vetëm në rrethana specifike.

13 Keni ndonjë arsye për të kundërshtuar parashtrimin tim?

14 PË. Në praktikë unë kam vepruar kështu.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës kërkoj që ky  
16 dokument të pranohet si provë.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] S'kemi kundërshtim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00225260-  
19 ET dhe dokumenti origjinal, pranohen.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Marrin numrin e provës  
21 materiale 1D30.

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PY. Dua të tregoj një dokument që jua ka treguar edhe  
24 Prokuroria.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] E kam për transkriptin dhe është

1 faqja 5536, rreshtat 22 dhe 23. Është përmendur kjo pra në  
2 transkript. Është dokumenti U0009858 deri në U0009888.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është prova materiale  
4 me numër P165.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
6 çaktivizuar.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3, neni 1.

8 PY. A mund ta lexoni vetë nenin 1 z. Mustafa dhe na bëni me  
9 dije kur ta keni mbaruar leximin.

10 PË. "Ushtarak është shtetase/shtetasja që shërben të radhët e  
11 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë ose kryen detyrimet e  
12 përcaktuara..."

13 PY. Jo, jo. Nenin 1. Më sipër. Neni 1(1).

14 PË. Po.

15 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës për të kryer detyrat e saj  
16 të rëndësishme duhet të ketë gjithmonë dhe në çdo rrethanë një  
17 disiplinë të fortë të bazuar në kushtetutë, në aktet ligjore e  
18 nënligjore.

19 "2. Rregullorja e Disiplinës përmban normat më të  
20 domosdoshme që kanë të bëjnë me disiplinën e ushtarakëve që  
21 shërbejnë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës."

22 Mbarova.

23 PY. Faleminderit, z. Mustafa. Kishte kushtetutë Kosova në  
24 vitin 1998?

25 PË. Ka qenë një draft që nuk ka hyrë në fuqi asnjëherë, i

1 quajtur Kushtetuta e Kaçanikut.

2 PY. Kosova kishte dispozita ligjore dhe akte nënligjore?

3 PË. Kishte -- ka pasur deri në kohën kur ne ishim përjashtuar  
4 nga institucionet -- shqiptarët kanë qenë të përjashtuar nga  
5 çdo institucion shtetëror edhe arsimor, kështu që ne tani  
6 ishim në kundërshtim me ata që po e mbanin Kosovën me dhunë.

7 PY. Pyetja ime është kjo: Çfarë kushtetute, çfarë  
8 dispozitash, për cilën kushtetutë, për cilat akte ligjore dhe  
9 nënligjore flitet në nen? Pra, ku thuhet "bazuar në  
10 kushtetutë, në aktet ligjore, nënligjore" për cilat bëhej  
11 fjalë?

12 PË. Me siguri nga trashëgimia ligjore e ish-sistemit të ish-  
13 Jugosllavisë ku edhe Kosova bënte pjesë. Por nuk mundem me  
14 thënë me saktësi tash.

15 PY. Në rregull. Flasim për inspektimin e 27 tetorit 1998 që  
16 kreu Shtabi i Përgjithshëm në zonën e Llapit. Ka disa pyetje  
17 lidhur me këtë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim provën materiale P00181.  
19 Fillimisht do të doja të shohim faqen SPOE00226667.

20 PY. Këtë faqe jua treguan dje dhe ju bënë pyetje lidhur me  
21 këto shënime sepse këtu përmendet Remi, në një nga pikat  
22 thotë:

23 "Lufta speciale dhe propaganda nuk është e pranishme".

24 Unë do ju pyes a do të thotë kjo me aq sa ju kujtohet ju,  
25 do të thotë kjo që s'ka pasur luftë speciale nga Serbia në

1 zonën e Llapit në tetor 1998 apo është një ankesë nga ana juaj  
2 kjo që Shtabi i Përgjithshëm nuk po angazhohet në luftën e vet  
3 speciale lidhur me propagandën në zonën tuaj?

4 PË. Nuk kam koment. Është një dokument që s'po më kujtohet,  
5 por kanë folur për luftë speciale të veçantë, me siguri.

6 PY. A mund të ketë qenë e mundur që nuk ka pasur luftë  
7 speciale apo propaganda nga serbët në zonën e Llapit në tetor  
8 1998?

9 PË. Ata kanë pasë gjithherë propagandë.

10 PY. Shohim një rresht më sipër ku thuhet:

11 "Çështja e administratës civile nuk është zgjidhur sepse  
12 ka nevojë për platformë të përshtatshme zyrtare".

13 Kjo pika a lidhet me diskutimin që patëm pak më herë sa i  
14 takon takimit që patët me Shaun Byrnes dhe KDOM-in lidhur me  
15 krijimin e institucioneve civile pas lirit?

16 PË. Mund të jetë kjo z. avokat. Është çështje memorie në  
17 pyetje. Unë nuk mundem me u fokusu saktë po kjo mund të jetë.  
18 Mund të lidhet.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim SPO002226672. Të njëjtin  
20 dokument. Madje, një faqe më sipër që të kuptojmë kush është  
21 folësi, kush pretendohet që është folësi.

22 PY. Në fillim të faqes, në krye të faqes, është emri  
23 "Leka, komandanti i brigadës 151". Edhe njëherë, kush është  
24 Leka?

25 PË. Është shefi i shtabit Nuredin Ibishi dhe komandanti i

1 brigadë 151 për atë kohë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen tjetër.

3 PY. Shefi i shtabit tuaj:

4 "Apel: Mos krijoni thyerje dhe përçarje mes popullatës.

5 Të merren masa konstruktive në drejtim të pajtimit kombëtare."

6 Për çfarë bëhet fjalë këtu? Për cilën bëhet fjalë?

7 PË. Nuk e kam të kjartë tash, po me siguri ka qenë ndonjë

8 specifikë që ai ka dëgjuar për atë specifikë edhe e ka thënë.

9 Nuk kam koment.

10 PY. Duket, ngjason, duket sikur është një apel që të krijohet

11 unitet mes popullatës dhe të mos krijohen përçarje mes

12 komunitetit shqiptar. A mendon se është e saktë kjo?

13 PË. kjo ka qenë përpjekje e gjithhershme e jona.

14 PY. A ishit në dijeni ju që pak ditë më pas, pra pak ditë pas

15 këtij inspektimi u arrit një draft marrëveshja, u bë një draft

16 marrëveshjes midis UÇK-së edhe FARK-ut?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ta kërkoj që të shfaqet

18 dokumenti.

19 PY. Për t'ju pyetur nëse e njihni.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Është prova materiale 061168-ET

21 dhe shqipja është 061167 deri në 061171 dhe 061168.

22 PY. E keni parë ndonjëherë më parë këtë dokument?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Madje mund të shohim edhe faqen

24 tjetër ku janë dhe nënshkrimet.

25 DËSHMITARI: Jo, nuk e kam pa asnjëherë. Nuk ka qenë

1 çështje e regjionit tim asnjëherë kjo çështje, kjo temë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Po ishit në dijeni të një draf marrëveshjeje mes UÇK-së  
4 edhe FARK-ut pak a shumë rreth -- në 2 nëntor -- pak a shumë  
5 në 2 nëntor.

6 PË. E parëndësishme -- edhe nëse e kam ditur është e  
7 parëndësishme për mu. S'ka qenë e rëndësishme për mu. Se mbaj  
8 mend.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim edhe një herë dokumentin që  
10 sapo patëm në ekran që është prova materiale me numër P00181.

11 Dhe për këtë do të doja që të kalonim në seancë private.  
12 Për pyetjet që kam lidhur me këtë dokument.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në  
14 seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

14 Z. MISETIC: [Përkthim]

15 PY. Do të flasim për dhjetorin 1998, z. Mustafa. A ju  
16 kujtohet në dhjetor 1998 ka pasur një farë tensioni lidhur me,  
17 në rrugën Prishtinë-Podujevë, dhe tension që u shkaktua nga  
18 tërheqja e forcave jugosllave dhe avancimi i forcave tuaja në  
19 atë rrugë, në atë vijë. Ju kujtohet?

20 PË. Po.

21 PY. A mund t'i tregoni Trupit Gjykses për çfarë ishte ky  
22 tension?

23 PË. Ka qenë përpjekje e forcave serbe për të hyrë në fshatrat  
24 ku ne po përpiqeshim të mbizotëronim dhe ka pasur dyluftim.

25 PY. Pati ndonjë problem që u shkaktua prej faktit që forcat

1 tuaja kishin avancuar afër magjistrales Prishtinë-Podujevë dhe  
2 a ju inkurajoi z. Walker dhe të tjerë që të tërhiqeshit nga  
3 magjistrallja?

4 PË. Po ne kishim shfrytëzimin dimrin po edhe armëpushimin dhe  
5 ishim afruar buzë magjistrales për të qenë më afër popullit  
6 dhe mbijetesa ka qenë më e lehtë për ne. Edhe ka pasë një  
7 presion edhe nga forcat armike, po edhe misioni që udhëhiqej  
8 nga William Walker që ne të largoheshim më lart.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të kalojmë sërish në seancë  
10 private.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në  
12 seancë private.

13 [Seancë private]

14 [Seancë private teksti i fshirë]

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 73

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04746 (Vijon) (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 74

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të nderuar  
13 Gjykatës, jemi në seancë publike.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

15 Z. MISETIC: [Përkthim]

16 PY. Të kalojmë tek vizitat nga delegacioni i OSBE-së në zonën  
17 e Llapit.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që të shfaqet në ekran  
19 prova materiale P00116. Ju kërkoj ndjesë, e thashë gabim.

20 Është prova materiale 1D00007 dhe versioni në gjuhën shqipe

21 1D00007-AT. Ju lutem mos e tregoni në ekran. Nuk është në

22 ekran apo jo. Në rregull.

23 PY. Juve ju bënë disa pyetje që i kishit dhënë një grupi të

24 OSBE-së leje që të intervistonin ca persona të ndaluar në

25 Llapashticë. Dua t'ju tregoj një procesverbal të këtyre

1 intervistave dhe më pas dua t'ju bëj disa pyetje lidhur me  
2 këtë gjë.

3 Ju lutem shihni paragrafin e dytë ku thuhet:

4 "Të tetë të ndalurit pohuan se kushtet e jetesës ishin të  
5 mira. Ata pretenduan se kishin të njëjtin ushqim si ushtarët,  
6 kishin krevat, batanije dhe mundësi për të përdorur tualetet  
7 dhe mundeshin të dilnin përjashta duke i bërë kërkesë rojës.  
8 Asnjë prej tetë të ndaluarve nuk kishte qasje prej  
9 televizionit, gazetave dhe të tjerë, po këto nuk dukeshin  
10 veçanërisht të bezdisur për këtë gjë..."

11 Z. Mustafa kështu mendoni se kanë qenë kushtet e këtyre  
12 individëve? Do ju kërkoja të mos përdornit emrat e tyre, por  
13 thjeshtë po ju pyes kështu kanë qenë kushtet në të cilat kanë  
14 jetuar këta të ndaluar?

15 PY. Në rregull.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se do të kalojmë në  
17 faqen...

18 PY. Dhe në qoftë se do i referohemi personit të dytë, përsëri  
19 do ju lutesha të mos e përdorni emrin e tij, të mos e thoni  
20 emrin e tij. Thuhet që "ai është ndaluar prej 19 ditësh".

21 Fjalia e katërt thotë që:

22 "Kishte probleme shëndetësore për shkak të një problemi  
23 në shtyllën kurrizore që i ishte shkaktuar gjashtë vite më  
24 parë dhe që ishte kuruar nga një mjek 10 ditë më parë."

25 Zona jua j a ofronte kujdes mjekësor për të ndaluarit, me

1 aq sa keni dijeni ju?

2 PË. Po, besoj që po, nuk kam memorie, nuk po më thotë asgjë,  
3 por nuk ka qenë e ndaluar, sigurt.

4 PY. Pa përmendur asnjë emër, a mund të na thoni në qoftë se  
5 ju kujtohet se kush ka qenë mjeku. Po apo jo, pa detaje të  
6 tjera.

7 PË. Mjeku, shefi i sanitetit për regjionin tim ka qenë  
8 Skënder Murati.

9 PY. Në rregull. A është e mundur që doktor Murati të ketë  
10 ofruar kujdes ndaj të ndaluarve në zonën tuaj?

11 PË. Po, është e mundur.

12 PY. A keni shkruar ndonjëherë ndonjë manual për ligjet e  
13 luftës dhe ja keni dërguar këtë manual njësiveve tuaja?

14 PË. Kanë mujt me bo stafi manual edhe në formë të  
15 rekomandimeve me e dërgu përmes njësiveve.

16 PY. Kush i ka shkruajtur këto manuale?

17 PË. Stafi, shefi i shtabit edhe stafi që ishin që ka pasë  
18 referenta pranë eprorëve pranë nesh që janë marrë me këto  
19 çështje.

20 PY. A do ishte ky z. Kastrati?

21 PË. Edhe ai ka qenë.

22 PY. Do t'ju bëj një pyetje lidhur me qershorin e 1999-s. A  
23 keni marrë pjesë në zbatimin e marrëveshjes së çmilitarizimit?

24 PË. Po.

25 PY. A është e saktë se keni marrë pjesë në mbledhjet ose

1 takimet e organizuara me Gjeneralin Jackson sa i takon

2 demilitarizimit?

3 PË. E saktë.

4 PY. Po Gjenerali Çeku a ka marrë pjesë në ato takime bashkë  
5 me ju?

6 PË. Po. Ai e udhëhiqte ekipin tonë, komandantët e zonave  
7 shkonte në takim. Bënim bashkë në takim.

8 PY. Pra, Gjeneral Çeku dhe komandantët e zonave ishin  
9 personat që janë taktuar me gjeneralin Jackson sa i takon  
10 zbatimit, kështu?

11 PË. Saktë.

12 PY. Thuajse kam përfunduar me pyetjet e mia z. Mustafa. Kam  
13 dhe disa pyetje të tjera të cilat kanë nevojë që të përgjigjen  
14 prej jush, që do të më vinin në ndihmë. Pyetja e parë prej  
15 këtij grupi pyetjesh është: A ju kujtohet në 2001 që si i  
16 oficer i lartë në Trupat e Mbrojtjes së Kosovës që jeni  
17 vendosur në listën e sanksioneve të Shteteve të Bashkuara? A  
18 ju kujtohet kjo?

19 PË. Po.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem paraqiteni këtë dokument  
21 DHD00115 deri në DHT00119-ET. Mban të njëjtin numër dhe në  
22 gjuhën shqipe vetëm se përfundon me AT në fund.

23 Ky është vendimi i 2001 dhe do të kërkoja që ky dokument  
24 të pranohet si provë materiale.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti  
2 pranohet si provë materiale.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] [Nuk ka përkthim]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Një çast ju lutem.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
6 është prova materiale me numër 1D31.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Emri juaj a vazhdoi që të mbetej në atë listë edhe në  
9 2003?

10 PË. Po.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky dokument është DHT00120 deri në  
12 DHT00129-ET. Dokumenti në shqip mban të njëjtin numër por  
13 përfundon me AT.

14 Kërkoj që të regjistrohet si provë materiale ky dokument.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka  
16 kundërshtim?

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti me  
19 numër identifikimi të përmendur më sipër që mban datën 29 maj  
20 2003, Sanksionet e Shteteve të Bashkuara pranohet në prova  
21 materiale.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
23 merr numrin e provës materiale 1D32.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit znj. Sekretare  
25 seancës.

1 PY. Z. Mustafa, në fund të pyetjeve të Prokurorisë ju bënë  
2 disa pyetje lidhur me emërimin tuaj si këshilltar i  
3 Presidentit Thaçi në vitin 2019. Dëshiroj t'ju pyes në qoftë  
4 se e keni ndryshuar dëshminë tuaj në ndonjë mënyrë si  
5 rezultat i caktimit si këshilltar i z. Thaçit?

6 PË. Jo, z. avokat. Unë kam shkuar librin, kur kam bërë këto  
7 intervista as që kam menduar ndonjëri i gjallë që z. Thaçi do  
8 të jetë pranë Gjykatës. Unë kam pasë të njëjtin qëndrim gjatë  
9 luftës, pas luftës edhe sot.

10 PY. Dua që të jetë e qartë për procesverbal. Gjërat që keni  
11 dëshmuar këtu në Gjykatë, a janë ndryshuar apo a janë mbajtur  
12 prej jush si rezultat i emërimit si këshilltar i Presidentit  
13 Thaçi? A ka pasur ndonjë ndikim emërimi juaj si këshilltar i  
14 z. Thaçi mbi atë çfarë keni thënë përpara Gjykatës?

15 PË. Jo, z. avokat.

16 PY. Z. Mustafa, faleminderit për kohën. Kemi mbërritur në  
17 fund të pyetjeve që kisha për ju.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më kërkuat  
19 që t'ju kujtoja.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë  
21 pushimin e drekës tani.

22 Dëshmitar, do të bëjmë pushimin e drekës dhe do të  
23 kthehemi përsëri në orën 2.30 në mënyrë që të vazhdohet me  
24 kundërpjetet nga Mbrojtja e z. Veseli.

25 Ka ndonjë gjë tjetër për t'u shtuar nga palët?

1 Sekretare, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin jashtë sallës së  
2 gjyqit.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa  
5 të bëjmë pushimin e drekës, e dëgjuat Prokurorinë që do të  
6 kërkojë dhënien e dëshmisë përmes videolidhjes javës që shkoi.  
7 A ka ndonjë kundërshtim lidhur me këtë kërkesë të Prokurorisë?

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të di se  
9 për çfarë arsyes bëhet fjalë. Unë preferoj që dëshmitarët të  
10 jetë këtu të pranishëm, por në qoftë se janë arsye  
11 shëndetësore, e kuptoj këtë gjë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam  
13 përshtypjen që Prokuroria tha që për arsye shëndetësore.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Mirë në rregull na e jepni këtë gjë,  
15 na e jepni këtë informacion edhe përmes postës elektronike  
16 sepse duhet të konsultohem me klientin tim.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e njoftova  
18 faktin që kjo është dhënë përmes parashtrimit të protokolluar  
19 që është numër 1672.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] A e thua edhe një herë, se nuk ju  
21 kuptova ju lutem.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, kemi bërë njoftimin përmes  
23 parashtrimi i protokolluar për kërkesën për videolidhje.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jepen aty edhe arsyet.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Në rregull, do ju përgjigjemi lidhur  
2 me këtë Gjykatës pasi të kthehemi nga dreka.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtu  
4 përfundon seanca e paradites.

5 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.48

6 --- Seanca rifillon në orën 14.30

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shpresoj të  
8 kem zë për pjesën e mbetur të pasdites. Më kujtoni që të mos  
9 bëj më pesë ditë radhazi seanca se është goxha e vështirë.  
10 Mund të sillni dëshmitarin.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Ishte diçka lidhur me dëshmitarin që  
12 the do ta diskutojmë pasi të kthehemi nga pushimi -

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prisni një  
14 çast. Po vazhdoni.

15 Z. KEHOE: [Përkthim] U konsultova me Prokurorinë. Nuk  
16 kemi asnjë kundërshtim që ky dëshmitari ta bëjë dëshminë me  
17 videolidhje. Nuk duam që të kthehet në praktikë, por e  
18 kuptojmë që aranzhimet, organizimet janë të vështirë. E  
19 vlerësojmë edhe nuk kemi asnjë kundërshtim rrjedhimisht.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë nga  
21 ekipet e tjera të Mbrojtjes?

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

23 Z. ELLIS: [Përkthim] I njëjti qëndrim.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,  
25 dakord.

1 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mund t'ju jap një përditësim  
2 lidhur me planifikimin. Dëshmitari i radhës që duam të  
3 thërrasim në këtë bllok dëshmitarësh është dëshmitari me numër  
4 02153 dhe është i disponueshëm të japë dëshmi nga e marta e në  
5 vijim.

6 Pastaj nëse nevojitet edhe një dëshmitar tjetër rezervë,  
7 atëherë do të jetë dëshmitari me numër 04586 me videolidhje,  
8 dhe videolidhja mund të bëhet ditën e enjte, sigurisht në  
9 varësi të miratimit të kërkesës sonë edhe të çdo aranzhimi,  
10 organizimi tjerë logjistik.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni  
12 çaktivizuar]

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dëshmitari i parë do ta japë  
14 dëshminë, duke qenë, dëshmitari, dëshmitari që përmenda  
15 përpara do të jetë i pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit.

16 Është dëshmitar sipas rregullës 154.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë mirë.  
18 Tani mund të sillni dëshmitarin.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të  
21 uleni.

22 Vazhdojmë me ekipin e Mbrojtjes të Veselit. Janë  
23 kundërpyetjet të ekipit të Mbrojtjes së Veselit. Z. Emmerson  
24 në të djathtën tuaj do t'ju bëjë pyetje.

25 Z. Emmerson, mund të vazhdoni.

1 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

2 Z. EMMERSON: [Përkthim]

3 PY. Mirëdita. Kam shumë pak tema që dua të mbuloj dhe pyetjet  
4 e mia shpresoj të jenë të shkurtra dhe të jenë të  
5 drejtpërdrejta.

6 Së pari, dua t'ju bëj disa pyetje të vogla sqaruese sa i  
7 përket Latif Gashit. Na the diçka të tipit që Latif Gashi u  
8 emëruar në zonë, a mund t'ju pyes të na sqaroni çfarë ndodhi  
9 lidhur me Latif Gashin kur përfundoi konflikti. Më  
10 konkretisht, a mbeti, a vazhdoi të ishte zëvendësi juaj në  
11 TMK, pra? Në atë kohë, për një periudhë kohore të paktën.

12 PË. Për një periudhë kohore të shkurtër ai ka qenë anëtar i  
13 Trupave të Mbrojtjes së Kosovës.

14 PY. Ju kujtohet pas përfundimit të luftimeve a ju kujtohet  
15 një rast kur ia keni prezantuar atë, për herë të parë, Kadri  
16 Veselit pas luftës?

17 PË. Nuk më kujtohet, por me siguri unë e kam njoh me të.

18 PY. Por pyetja kryesore është, juve nuk ju kujtohet të jetë  
19 bërë një takim ku ka ndodhur ky prezantim, pas konfliktit?

20 PË. Jo.

21 PY. Tani do të kaloj në një pikë tjetër. Kam disa pyetje në  
22 këtë temë sa i takon marrëdhënies mes komandantëve të zonës  
23 dhe Shtabit të Përgjithshëm. Disa prej komandantëve të zonës,  
24 ai ishin disa karaktere më të vështirë, sesa të tjerët?

25 PË. Ka ndërru personaliteti i tyre, por detyrat ishin të

1 njëjta; personalitetet kanë ndërru.

2 PY. Por detyrat që ushtronin ishin të njëjtat. Por ka pasur  
3 shumë diskutime mes komandantëve të zonave dhe mes  
4 komandantëve të zonave dhe Bislir Zyrapit gjatë takimeve  
5 periodike sa i takon qëndrimin që komandantë e zonave kishin  
6 karshi rolit dhe veprimet të Shtabit të Përgjithshëm.

7 PË. Po, ka pas shumë diskutime.

8 PY. Shumë prej tyre ishin kritikë ndaj Shtabit të  
9 Përgjithshëm apo jo?

10 PË. Po, ne ishim më kërkues.

11 PY. Po. Ju përgjigjët disa prej pyetjeve nga z. Misetic sa i  
12 takon Rambujesë, kufijve [sipas përkthimit] që kishit edhe  
13 urdhrave që kishit ndjekur të mos zbatonit. Meqë në Rambuje  
14 ishte vetëm Shtabi i Përgjithshëm dhe ju e autorizuat si  
15 komandant zone përfaqësinë që do të merrte pjesë në Rambuje, a  
16 pajtoheni në këtë kontekst që i bie që ata kanë qenë vartës  
17 tuaj dhe jo anasjelltas? Ata s'mund të merrnin vendime, s'mund  
18 të hynin në marrëveshje pa autoritetin tuaj.

19 PË. Edhe unë po them se s'kanë mund me bo marrëveshje pa u  
20 thërrit pa ne, pa na pyet ne.

21 PY. Në strukturën e forcave të armatosura, në përgjithësi,  
22 komandën e drejton shtabi i përgjithshëm edhe komandantët janë  
23 vartës. Kjo është struktura normale ushtarake, që i bie në  
24 krye të organizatës të jetë shtabi i përgjithshëm. Po a  
25 pajtoheni me mua që për periudhën që po flasim ne kjo lloj

1 marrëdhënie ka qenë e kundërta, ky raport, ka qenë pikërisht e  
2 kundërta.

3 PË. Ne s'kemi mbërri deri aty sa të bëhej ushtria që të  
4 udhëhiqej nga Shtabi i Përgjithshëm, nga politikanët nga  
5 civilët. S'kemi mbërri kurrë deri aty. Gjithherë ne kemi qenë,  
6 jemi konë ata që jemi pyet për regjionin tonë për punë  
7 ushtarake.

8 PY. Se në realitet ju ishit burrat dhe gratë, kryesisht  
9 burrat që luftonit në terren apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Ndërsa ata ishin një grup personash që nuk kishin as  
12 përvojë ushtarake asokohe, kryesisht, me përjashtim të Bislim  
13 Zyrapit, pjesa tjetër s'kishin ndonjë përvojë ushtarake apo  
14 jo?

15 PË. Ata ishin njerëz që donin të koordinonin dhe ngjiteshin  
16 majave të politikave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Po  
17 provonin.

18 PY. Në momente të ndryshme si ju personalisht, si komandantët  
19 e tjerë të zonave e keni kundërshtuar vendimin, i keni  
20 kundërshtuar vendimet që merrte Shtabi i Përgjithshëm,  
21 përfshirë edhe emërimin e zëvendëskomandantëve e kështu me  
22 radhë. Pikërisht sepse nuk kishin përvojë ushtarake dhe ju  
23 donit që në krye të Shtabit të Përgjithshëm të ishin persona  
24 me përvojë ushtarake. Është e drejtë ta themi kështu?

25 PË. E drejtë është.

1 PY. Po ashtu, është e drejtë të themi që ju po ashtu mendonit  
2 që ishte mirë që të projektohej tek ndërkombëtarët fakti që ju  
3 i kishit rangjet dhe rolet që ata t'ju merrnin seriozisht; ata  
4 të mendonit që ju ishit një forcë ushtarake e koordinuar siç  
5 duhet. Dëshët që ta projektonit këtë imazh te këta apo jo?

6 PË. Po. Përpiqeshim [e pakuptueshme].

7 PY. Do shohim edhe shembujt për një çast, më konkretisht, por  
8 ju ishit të ndërgjegjshëm dhe kur them ju, e kam edhe për ju  
9 personalisht, por edhe për komandantët e tjerë të zonave. Ju  
10 ishit të ndërgjegjshëm për faktin që duhet të nxirrnit disa  
11 elementë të caktuar të organizatës suaj që t'ju pasqyronin ju  
12 si një forcë e armatosur e organizuar dhe nuk deshtë që të  
13 pasqyronit sikur të ishit një grup i armatosur, joshtetëror i  
14 çorganizuar, është e drejtë kjo?

15 PË. Korrekt.

16 PY. Pra, bashkërisht merrnit vendimet; vinit, jepnit  
17 emërtime, tituj, krijonit dokumente në drejtime të ndryshme,  
18 të cilat synonin të krijonin një, të jepnin përshtypjen që nuk  
19 përputhej domosdoshmërisht me faktet. A pajtoheni me mua?

20 PË. Po.

21 PY. Në njëfarë mënyre, duke patur parasysh Rambujenë dhe  
22 urdhëresat e tjera që ose i zbatonit ose nuk i zbatonit, folëm  
23 edhe për rendin e kundërt të pushtetit. A pajtoheni me mua që  
24 të krijosh një organ që u quajt Shtabi i Përgjithshëm, në fakt  
25 ishte pjesë e këtij procesit, t'i bënte përshtypje grupit

1 ndërkombëtar. T'u jepej atyre përshtypja që kishte një grup  
2 personash me të cilët mund të flisnin e të cilët mund të  
3 flisnim në emër të UÇK-së. Pra, ishte synuar të krijohesh për  
4 të dhënë këtë përshtypje?

5 PË. Po.

6 PY. Ndonëse, në fakt, na thatë që ata s'kishin pushtet të  
7 negocionin për llogari të UÇK-së pa marrë pëlqimin tuaj  
8 paraprakisht?

9 PË. Sigurisht.

10 PY. A pajtoheni me përshkrimin tim kur them se njëfarë mënyre  
11 Shtabi i Përgjithshëm ishin thjesht fiktiv? Ishin krijuar për  
12 të mbuluar një realitet që në fakt ishte krejt ndryshe, pra,  
13 nuk ishin ajo që përcillnin?

14 PË. Po, pajtoj.

15 PY. Marrim shembullin e z. Misetic, ku bëtë një ndërhyrje të  
16 drejtpërdrejtë nga Shtabi; keni një ndërhyrje nga Shtabi i  
17 Përgjithshëm ku ju kërkoi të ndryshonit taktikat ushtarake për  
18 shkak të trysnisë ndërkombëtare. Pra, ju kërkuan të  
19 largoheshit nga pozicionet që kishit zënë, sepse konsiderohej  
20 provokim. E mbani mend këtë dokumentin për të cilët biseduat  
21 më herët?

22 PË. Po, e mbaj mend.

23 PY. Edhe shpjeguat se si ju kontaktoi dhe në mënyrë të  
24 drejtpërdrejtë një nga organizatat ndërkombëtare. Po unë dua  
25 të fokusohem konkretisht tek qasja e Shtabit të Përgjithshëm.

1 Ju vendosët të mos e zbatonit kërkesën e tyre; në një moment  
2 gjatë dëshmisë thatë lidhur me Rambujenë më kujtohet, thatë që  
3 s'mund, edhe sikur të donin s'mund të bënin gjë.

4 E kam kuptuar siç duhet dëshminë tuaj që gjatë '98 dhe  
5 '99 edhe sikur Shtabi i Përgjithshëm të mos pajtohej me  
6 komandantët e zonave për mënyrën se si i kryenin operacionet  
7 apo çdo aspekt tjetër në zonën e tyre përkatëse, Shtabi i  
8 Përgjithshëm nuk kishte pushtet, nuk kishin as forcat e  
9 armatosura për t'u imponuar dhe për të t'ju detyruar që të  
10 zbatonit vullnetin e tyre?

11 PË. Po.

12 PY. Kur shohim një urdhëresë të Shtabit të Përgjithshëm, ju  
13 kur shihnit një urdhëresë të Shtabit të Përgjithshëm ju  
14 mendonit, pra, ju kishit përshtypjen se mund ta zbatonit ose  
15 jo. Pra, ishte në dorën tuaj, ishte në varësi të vlerësimit  
16 dhe nevojave të zonës suaj përkatëse ushtarake, kështu? Zonës  
17 tuaj, më falni, kështu?

18 PY. Unë jam përpjek që të zbatoj gjithherë, por ka raste kur  
19 nuk i kam përfill.

20 PË. Po a ishte urdhër, a mund të jetë, a mund të jetë diçka  
21 urdhëresë në qoftë se vendos ta zbatosh ose jo? Si rregull, në  
22 një ushtri, kur jepet një urdhër duhet të zbatuar pa e vënë në  
23 dyshim vartësi këtë urdhëresë. A mendon se termi "urdhëresë"  
24 është përkufizimi i duhur në qoftë se dikush vendos të mos e  
25 zbatojë, apo mund të jenë thjesht kërkesa apo sugjerime që

1 dikush pastaj vendos t'i zbatojë ose jo?

2 PË. Kuptohet, në ushtrinë e rregullt urdhri zbatohet, por ne  
3 edhe urdhëresat në atë kohë i merrnim si rekomandime. Ne  
4 besonim se më mirë e njehnim situatën në terren nga venim,  
5 sesa Shtabi i Përgjithshëm. Dhe Shtabi i Përgjithshëm nuk e  
6 njehte terrenin sikur ne.

7 PY. Kuptova.

8 Kjo ishte një përgjigje e rëndësishme dhe do ju pyes  
9 prapë lidhur me këtë, sidomos sa i takon qasjes së Ramush  
10 Haradinajt kundrejt Shtabit të Përgjithshëm. Ti the që nuk e  
11 njihnin situatën siç e njihnim ne në terren. Do flasim për një  
12 çast prapë për këtë.

13 Ishte e njëjta gjë, mos ishte e njëjta situatë brenda  
14 zonës apo ishte ndryshe? Për shembull, kur ti jepje një urdhër  
15 një vartësi, si mendoje ti, ata e kishin vetë në dorë ta  
16 zbatonin ose jo? Në qoftë se urdhëroje një vartës në zonën  
17 tënde, të bënte ose të mos bënte diçka, ky merrej si gjë e  
18 lirë, duhet ta zbatonit se ishte urdhër apo kushdo bënte çfarë  
19 donte në zonën tënde?

20 PË. Ne nuk ia arritëm deri në fund asnjëherë, sepse lufta  
21 përfundoi shpejt fatmirësisht, por ne përpiqeshim të vejmë  
22 rregull. Nuk do të thotë që ia kemi dalë.

23 PY. Kuptoj këtë, por kur i drejtoheshe një prej vartësve të  
24 lartë, të bënte diçka, nga ky vartës prisje që ta zbatonte  
25 këtë?

1 PË. Po, ato pritje i kam pas gjithherë.

2 PY. Dhe ata, sigurisht, e dinin që duhet ta bënin diçka të  
3 tillë.

4 PË. Po, e kanë kuptuar.

5 PY. Dhe ju, prezumojmë, nuk mund të pretendonit që të  
6 nesërmen të të vinte vartësi dhe të thoshte, pra, të nesërmen  
7 ju nuk prisnit që të të vinte vartësi, një vartës i lartë dhe  
8 të thoshte, shiko, e mendova gjatë natës unë, por nuk do ta  
9 bëj atë që më the, sepse unë mendoj që e di më mirë. Pra, nuk  
10 do prisje një sjellje të tillë në zonën tënde prej një prej  
11 komandantëve tuaj apo jo?

12 PË. Po, nuk e kanë, nuk ka qenë kjo e zakonshme.

13 PY. Kur thua, kjo nuk ka qenë diçka e zakonshme, atëherë do  
14 t'ju bëj, do e ndryshoj pyetje. Kur jepje një urdhër si  
15 komandant i zonës, për zëvendëskomandantin, për shembull,  
16 urdhri ishte urdhër apo jo? Fjala "urdhër" kishte kuptimin  
17 tamam urdhër?

18 PË. Po. Po.

19 PY. Nuk ishte kërkesë siç e përshkruam për Shtabin e  
20 Përgjithshëm?

21 PË. Urdhër ishte.

22 PY. Pra, e kuptoni dallimin që po përpiqem të bëj unë, mes  
23 urdhrave që nxirrnit në nivel zone, urdhëresës suaj për të  
24 bërë diçka dhe çfarë përshkruat si kërkesa nga Shtabi i  
25 Përgjithshëm. Në fakt titullin e kishin "Urdhëresa", por ishin

1 diskrecionale? Linin liri veprimi.

2 PË. E kuptoj ndryshimin, por ne kemi përfunduar luftën dhe  
3 Shtabi i Përgjithshëm nuk ka mujt me u -- me qenë hierarki e  
4 respektive për dhënien e urdhnesave njësisive vartëse.

5 PY. Urdhra. Fiks. Kur thoni, "Ata s'mund të urdhëroni, s'mund  
6 të na jepnin urdhra dhe s'mund të pajtoheshim për asgjë pa  
7 pëlqimin tonë". Pa pëlqimin e komandantëve të zonave. Kjo do  
8 të thotë që në fakt ata s'mund t'ju jepnin urdhra apo jo?  
9 S'ishin në, sepse s'ishin në pozicion që të kërkonin zbatimin  
10 e këtyre urdhrave apo të siguronin zbatimin e këtyre urdhrave  
11 apo jo?

12 PË. E kjo. Nuk ka mund të japin urdhra përderisa ne s'i  
13 kemi njoftë. Ne i kemi njoftë shumë pak, shumë vonë. Ata ende  
14 nuk i kanë njoftë. Nuk ka pas besim të ndërsjellë sikur më  
15 vonë. Domethënë, nuk kanë mund të më urdhërojnë të veproj pa  
16 dëshirën time. Domethënë, nëse unë s'jam bind se është në  
17 rrugën e drejtë.

18 PY. E kuptoj plotësisht që në fakt kështu ka qenë realiteti  
19 në terren, por s'e kanë pas qartë të gjitha këta që janë në  
20 sallën e gjyqit se si funksionin gjërat në praktikë.

21 Dua që të shohim disa nga pasojat që kishte kjo. Dhe do  
22 flas pak më vonë për një takim ku keni marrë pjesë ju pak a  
23 shumë rreth periudhës së Rambujesë për të diskutuar  
24 perceptimin që kishit ju, komandantët e zonave për Shtabin e  
25 Përgjithshëm. Por do ta shikojmë për një çast këtë.

1 Megjithatë, në shënimet tuaja dhe në dëshminë tuaj është  
2 përmendur shpesh Ramush Haradinaj, komandant i zonës së  
3 Dukagjinit, ku keni kaluar ju për të shkuar në Shqipëri për të  
4 marrë dhe për të kthyer armët. Dhe ju thatë gjatë kësaj  
5 periudhe kur ndodhi kjo gjë, komandant Haradinaj ju ndihmonte,  
6 e bënte, ju ndihmonte me zonën e tij, pra, jua lehtësonte  
7 punën, kështu që e njihnit njëri-tjetrin goxha mirë apo jo?  
8 PË. Po. Nga takimi, kur jam taku me të më vonë ne kemi pas  
9 raporte të mirë dhe e kam njoh mirë.

10 PY. Që të krijojmë, që të japim përshtypjen çfarë pikëpamje  
11 kishin komandantët e zonave për Shtabin e Përgjithshëm, a mund  
12 të na e thuash me pak fjalë, në një mënyrë të përmbledhur, si  
13 e konsideroi Ramush Haradinaj vizitën, si i konsideronte, më  
14 falni, Ramush Haradinaj vizitat e Shtabit të Përgjithshëm në  
15 zonën e tij dhe në zonat e tjera. Çfarë ka thënë në mbledhje,  
16 çfarë ka thënë edhe jashtë mbledhjeve lidhur me Shtabin e  
17 Përgjithshëm dhe pushtetin e tyre përkundrejt komandantëve të  
18 zonave. Pra, çfarë pikëpamjesh kishte ai lidhur me këtë temë?  
19 Dhe cilat ishin këto pikëpamje sa i takon Shtabit të  
20 Përgjithshëm?

21 PË. E kam të vështirë të flas për pikëpamjet e të tjerëve,  
22 por shpeshherë nuk kanë qenë anëtarët e Shtabit të  
23 Përgjithshëm të nderuar nga ne. S'po du me fol personalisht  
24 për asnjërin.

25 PY. Pra, në përgjithësi, në terma të përgjithshme mund të

1 themi që komandantët e zonave nuk tregonin nivelin e duhur të  
2 respektit për Shtabin e Përgjithshëm. Tani nuk dua të flas  
3 shumë, sepse është bërë një gjykim për zonën e Dukagjinit dhe  
4 të gjitha janë të dokumentuara.

5 Por, Ramush Haradinaj, për shembull, ai mendonte se  
6 Shtabi i Përgjithshëm nuk është se po jepte ndonjë kontribut.  
7 Ai besonte që ishin pikërisht ata burra që mbanin armët; ai  
8 ishte një drejtues i fortë; ishte goxha i famshëm dhe i njohur  
9 në zonën e vet në Kosovë dhe ai nuk kishte ndjesinë që Shtabi  
10 i Përgjithshëm jepte kontribut të madh për këtë pjesë të  
11 luftës apo jo?

12 PË. Keni thonë saktë.

13 PY. Pra, ai e konsideronte veten efektivisht krejt të pavarur  
14 nga Shtabi i Përgjithshëm apo jo?

15 PË. Me ju thonë të drejtën gati secili prej ne ka ndodh  
16 ashtu.

17 PY. Ju të gjithë, të gjithë ju, komandantët e zonave e  
18 shihnit veten si të pavarur nga Shtabi i Përgjithshëm apo jo?

19 PË. Pothuajse se të gjithë, po.

20 PY. Unë nuk kam qenë në takime, por a pajtohesh me mua kur  
21 them që Ramush Haradinaj ishte një person që shprehte goxha  
22 përbuzje për Shtabin e Përgjithshëm shprehimisht?

23 PË. Mund të thuhet.

24 PY. Jo vetëm, jo vetëm tek komandantët e tjerë të zonave, por  
25 ia ka shprehur edhe vetë Shtabit të Përgjithshëm apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Ju kujtohet një mbledhje me Bislam Zyrapi, Bislam Zyrapi  
3 bëri një mbledhje me komandantët e zonave, pak a shumë rreth  
4 periudhës së Rambujesë. Dhe personi i parë që foli ka qenë  
5 Ramush Haradinaj edhe ai e sulmoi Shtabin e Përgjithshëm pse  
6 kishte emëruar akademikë si Jakup Krasniqi dhe nuk kishte  
7 emëruar ushtarë. A ju kujtohet kjo mbledhje? Mund t'ju ndihmoj  
8 sikur t'ju them që ai e ka filluar fjalimin duke e shkrepur  
9 një automatik në tavan që të tërhiqte vëmendjen e të gjithëve.  
10 Ju kujtohet kjo?

11 PË. Më kujtohet.

12 PY. Nuk është diçka që e harron kollaj kjo gjë. A përdori një  
13 emër, jo emër, term. Ju kujtohet termi që përdorte rregullisht  
14 për të përshkruar Shtabin e Përgjithshëm? Kur e përshkruante  
15 në raport me luftëtarët e vërtetë në terren. Kishte një term  
16 të vetin që e përdorte vetëm ai. Ju kujtohet?

17 PË. Nuk dëshiroj të flas shumë për këtë çështje, por  
18 shpeshherë i kemi përbuzur në takime. Ka pas raste që i kemi  
19 largu nga mbledhja, nga takimi.

20 PY. Ramush Haradinaj i thërriste "turistë", ju kujtohet?

21 PË. Më kujtohet, por nuk po dëshiroj të lëshohem në --

22 PY. Nuk po ju detyroj, po do shohim një procesverbal të një  
23 mbledhje ku ke thënë edhe ju diçka bashkë me Ramush Haradinaj  
24 se janë të dokumentuara. Dhe shohim disa nga komentet që keni  
25 bërë ju kur ju intervistoi ZPS-ja për këtë. Për këtë, për këtë

1 temë. Kam dy-tre pasazhe që dua të t'i tregoj dhe pastaj do ju  
2 kërkoj të komentoni ose t'i konfirmoni.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani s'i propozoj ta bëjmë, në  
